

ROMËT PËRKASIN



Pashtëtësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Shqipëri

PRILL 2018

CHALLENGING DISCRIMINATION PROMOTING EQUALITY



European
Network on
Statelessness





Copyright: © ERRC, ISI, ENS, TLAS, Prill 2018

Ju lutemi shikoni www.errc.org/permissions për më shumë informacion rreth përdorimit, shpërndarjes dhe citimit të këtij materiali apo materialeve të tjera nga ERRC

ISBN 978-963-89916-8-3

Dizajni: **Anikó Székffy**

Paraqitja: **Dzavit Berisha**

Publikuar nga: Molnár és Faragó Bt., Budapest, Hungari

Foto në kopertinë: © **ERRC**

Ky raport është publikuar në gjuhën angleze dhe shqipe

Adresa: 1077 Budapest, Wesselényi u. 16, Hungary

Tel: +36 1 413 2200

Fax: +36 1 413 2201

E-mail: office@errc.org

www.errc.org

MBËSHKETNI ERRC

Ondra Europiane për Të Drejtat e Romëve varet nga zemërgjerësia e donatorëve individual për të egzistuar në vazhdimësi. Ju lutemi të bashkoheni duke kontibuar të bëni të mundur të ardhmën e saj. Dhurime të shumave të ndryshme janë të mirë-seardhura dhe mund të bëhen përmes PAYPAL në faqen e internetit të ERRC (www.errc.org, shtypni butonin Donate majtas në krye të faqes kryesore) ose përmes transfertës bankare në llogarinë e ERRC:

Emri i Bankës: **BUDAPEST BANK**

Adresa e Bankës: **BÁTHORI UTCA 1, 1054 HUNGARY**

Mbajtësi i llogarisë: **EUROPEAN ROMA RIGHTS CENTRE**

Numri i llogarisë në EUR: **30P00-402686**

(EUR IBAN: **HU21-10103173-40268600-00000998**)

SWIFT (ose BIC): **BUDAHUHB**

Table of Contents

1	Prezantim i të Intervistuarve	3
2	Hyrje	7
	2.1 Metodologjia	8
	2.2 Rreth komunitetit Rom	9
	2.3 Diskriminimi dhe pashtetësia	10
3	Romët dhe Pashtetësia në Shqipëri	13
	3.1 Romët	13
	3.2 Pashtetësia	16
4	Standarde dhe Mekanizma të Rëndësishme Rajonale dhe Ndërkombëtare	19
5	Ligji dhe Korniza e Politikave Kombëtare	21
	5.1 Shtetësia	21
	5.2 Barazia dhe mosdiskriminimi	23
	5.3 Pashtetësia në ligjin kombëtar	25
6	Rregjistrimi i Lindjeve dhe Rreziku i Pashtetësisë	27
	6.1 Procedura e regjistrimit të lindjes dhe sfidat	27
	6.2 Legalizimi i dokumenteve të fëmijëve të lindur jashtë vendit	32
	6.3 Ndihma ligjore	33
	6.4 Adresimi i pashtetësisë	34
7	Margjinalizimi, Varfëria dhe Përjashtimi	37
	7.1 Aksesit në punësim	37
	7.2 Kushtet e strehimit	38
	7.3 Aksesit në kujdesin shëndetësor	39
	7.4 Aksesit në arsim dhe shkrim-lexim	40
8	Konkluzione dhe Rekomandime	41
9	Mirënjohje	47
10	Bibliografia	49

1. Prezantim i të Intervistuarve

Për qëllime të këtij raporti, janë intervistuar 14 persona dhe familje rome që përjetojnë pashtetësinë ose rrezikun e pashtetësisë. Më poshtë janë disa raste studimore të shkurtra që paraqesin historitë e tyre.¹

Adelina është nënë e tre fëmijëve. Ajo dhe burri i saj, të cilët janë shtetas shqiptarë, dhe fëmija i tyre më i madh u zhvendosën në Greqi dhe jetuan atje për gati dhjetë vjet, por nuk kishin status ligjor atje. Fëmija i tyre më i madh ka lindur në Shqipëri dhe është regjistruar në zyrën e gjendjes civile të Shqipërisë. Gjatë qëndrimit të tyre në Greqi, Adelina lindi dy fëmijë të tjerë. Për shkak të statusit të parregullt të prindërve të tyre, lindjet e fëmijëve janë regjistruar në fakt me informacione kyçe, si emrat e tyre, të munguara. Kur fëmijët e tyre ishin nëntë, gjashtë dhe pesë vjeç, ata u kthyen në Shqipëri. Adelina këmbëngul për faktin se ajo është jashtëzakonisht e varfër, ajo dhe burri i saj nuk marrin asnjë ndihmë sociale dhe fëmijët e tyre nuk pranohen në shkollë dhe në çerdhe për shkak se nuk kanë dokumentacion të vlefshëm. Certifikatat e tyre të lindjes greke nuk pranohen në Shqipëri, meqë ato nuk përfshijnë emrat e fëmijëve dhe nuk janë në formatin e kërkuar ligjor i cili pranohet nga zyra e gjendjes civile. Ata janë lënë në harresë. Adelina thotë se gjithçka që ajo dëshiron është që fëmijët e tyre të regjistrohen në mënyrë që ata të mund të marrin ndihmë nga shteti.

Kujtim dhe **Rovena** janë qytetarë shqiptarë. Ata janë të martuar dhe jetojnë në një qytet në jug të Shqipërisë. Shumë shqiptarë nga ky qytet, duke përfshirë shumë romë, udhëtojnë për në Greqi për të punuar. Gjatë një prej qëndrimeve të tyre në Greqi, një prej fëmijëve të tyre ka lindur atje. Ajo tani është tre vjeç dhe është në rrezik të pashtetësisë, pasi ajo nuk ka dokumentacionin e duhur - certifikata e lindjes është në greqisht dhe ka të regjistruar në mënyrë të pasaktë informacionin mbi prindërit e saj. Ashtu si fëmijët e Adelina, ajo nuk mund të ketë akses në çerdhe apo në kujdes shëndetësor.

Ilmi dhe **Lule** – të dy shtetas shqiptarë - janë prindërit e një vajze të vogël që është e peregjistruar dhe në rrezik të pashtetësisë. Ata gjithashtu jetonin në mënyrë të parregullt në Greqi, ku Lule lindi vajzën e tyre në një sallë materniteti. Ajo u pajis me një libër vaksinimi dhe një certifikatë nga spitali. Ajo kurrë nuk ka shkuar në zyrën e gjendjes civile për të verifikuar regjistrimin dhe ajo nuk zotëron ndonjë dokument të regjistrimit të lindjes. Ligji për shtetësinë greke thotë se fëmijët e lindur në Greqi, prindërit e të cilëve kanë jetuar ligjrisht dhe në mënyrë permanente në Greqi për pesë vite, mund të fitojnë shtetësinë greke. Meqënëse ato nuk ishin rezident të ligjshëm, fëmija i tyre nuk mund të fitojë shtetësi greke. Lule dëshiron që vajza e saj të jetë e regjistruar në Shqipëri, por të dy Ilmi dhe Lule janë të vetëdijshëm se nuk zotërojnë dokumentacionin e nevojshëm për të regjistruar lindjen e fëmijës së tyre atje.

Mimoza përballlet me një problem të ngjashëm. Vajza e saj lindi në Greqi, ku Mimoza jetonte në mënyrë të parregullt. Për shkak të varfërisë së saj, pas lindjes së saj, ajo u largua nga materniteti pa paguar shpenzimet mjekësore. Si rezultat, ajo nuk mori ndonjë dokument. Pas

1 Për të mbrojtur identitetin e të intervistuarve nuk janë përdorur emrat e tyre të vërtetë.

disa kohësh, ajo shkoi në zyrën e gjendjes civile dhe mori certifikatën e lindjes për vajzën e saj. Sidoqoftë, kjo certifikatë lindjeje nuk regjistroi emrin e vajzës. Autoritetet refuzuan të regjistronjë emrin e fëmijës, sepse ajo ishte e huaj dhe pa rezidencë ligjore. Mimoza pastaj u kthye në Shqipëri me fëmijën e saj dhe me certifikatën e lindjes nga Zyra e Gjendjes Civile të Greqisë. Më pas ajo shkoi në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri dhe kërkoi që fëmija i saj të regjistrohej. Autoritetet shqiptare nuk e pranuan dokumentin që ajo kishte, duke pretenduar se ishte i pavlefshëm për shkak se ajo kishte mungesë të të dhënave bazë siç ishte emri i fëmijës, që ishte në gjuhën greke dhe nuk ishte i legalizuar.

Lumturi është shtetase shqiptare. Ajo dhe burri i saj migruan në mënyrë të parregullt në Greqi pesëmbëdhjetë vjet më parë. Ata u ndanë dhe Lumturi filloi të jetonte me një shtetas tjetër shqiptar që jetonte pa status rezidence në Greqi, ndërsa ajo ishte ende e martuar ligjërisht. Gjatë kësaj marrëdhënie të re ajo lindi një vajzë dhe disa vjet më vonë një djalë. Fëmijët janë regjistruar pa emra në certifikatat e tyre në Greqi. Pas shumë vitesh si emigrantë pa dokumente, ajo dhe partneri i saj vendosën të kthehen në Shqipëri. Gjendja e saj financiare është jashtëzakonisht e dobët. As ajo as partneri i saj nuk marrin mbështetje sociale edhe pse kanë të drejtë të kenë. Fëmijët nuk shkojnë në shkollë për shkak të faktit se ata nuk janë të regjistruar. Atyre gjithashtu u mungojnë të gjitha shërbimet e tjera publike. Ajo po kërkon ndihmë nga shteti.

Shpresa është një nënë e re nga Shqipëria. Ajo është pa shtetësi dhe nuk ka ndonjë dokument për të vërtetuar identitetin e saj. Ajo ka dy fëmijë, të cilët janë pa shtetësi gjithashtu. Shpresa u lind në vitet '90, ndërsa prindërit e saj jetonin në mënyrë të pa rregullt në Gjermani. Në kohën e lindjes së saj, prindërit e saj dhanë një deklaratë të rreme për identitetin e tyre. Shpresa e identifikon veten si shqiptare. Ajo dhe fëmijët e saj flasin gjuhën shqipe. Ajo nuk mban mend që ka jetuar në Gjermani, sepse prindërit e saj e sollën atë në Shqipëri kur ajo ishte akoma një foshnjë. Babai i saj tani nuk jeton më. Nëna e saj është e gjallë dhe është shtetase shqiptare me dokumentacion. Shpresa ka kërkuar nga autoritetet të regjistrohet në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri bazuar në dokumentin e dhënë nga prindërit e saj - një certifikatë lindjeje të lëshuar nga autoritetet gjermane - dhe gjithashtu nga prejardhja e bazuar në shtetësinë shqiptare të prindërve të saj. Megjithatë, pasi ajo është një e rritur, ajo u informua se ajo duhet të aplikojë për nënshtetësinë shqiptare përmes një procesi natyralizimi. Fëmijët e saj nuk janë të regjistruar dhe ajo është në depresion. Ajo nuk i ka lindur fëmijët e saj në një sallë materniteti për shkak të mungesës së dokumentacionit. Si rrjellojë, fëmijët e saj janë gjithashtu të paregjistruar. Ajo thotë se nuk është faji i saj që prindërit e saj kanë emigruar dhe që ajo nuk ka dokumenta të rregullta. Ajo nuk mund ta rregullojë situatën e saj. Ajo nuk mund të udhëtojë, dhe për shkak të mungesës së dokumentacionit ajo nuk mund të martohet ligjërisht me babanë e fëmijëve të saj, as nuk mund t'u japë ligjërisht asgjë.

Flutura është në një situatë të ngjashme me Shpresën. Ajo është nënë e tre fëmijëve të vegjël. Ata të gjithë janë të paregjistruar. Flutura nuk ka dokumente për të vërtetuar identitetin e saj. Ajo ndihet shqipëtare dhe flet shqip. Ajo ka lindur në Shqipëri, por për shkak të një zjarri në spital, dokumentet që vërtetonin lindjen e saj u dogjën. Ajo i ka kërkuar autoriteteve ta regjistronjë atë, sepse ajo nuk ka dokumente për të provuar identitetin e saj. Autoritetet i kanë thënë se ajo është një e rritur dhe duhet të aplikojë për natyralizim. Fëmijët e saj nuk mund të

regjistrohen gjithashtu. Ata kanë lindur jashtë spitalit dhe ajo nuk ka asnjë dokumentacion të lindjeve të tyre. Ajo ndihet e shkatërruar. Ajo nuk mund të martohet me babanë e fëmijëve të saj që është shtetas shqiptar. Ajo po kërkon ndihmë.

Eni është një fëmijë i vogël nga prindër shqiptarë. Lindja e tij nuk ishte e regjistruar dhe ai është në rrezik të qenit pa shtetësi. Arsyeja për këtë situatë është se ai është interseks. Eni ka lindur në një sallë materniteti dhe ka një vërtetim lindjeje, por seksi i tij është regjistruar si 'hermafrodit'. Prindërit e Enit shpjegojnë se ata nuk e kanë regjistruar atë, sepse ligji nuk ofron ndonjë mundësi për të regjistruar seksin ndryshe nga "mashkull" ose "femër". Prindërit thonë se ndiejnë turp për gjendjen biologjike të fëmijës së tyre dhe e kanë ruajtur këtë sekret nga anëtarët e tjerë të familjes dhe komuniteti ku jetojnë. Ata thonë se duan që fëmija i tyre të identifikohet si mashkull dhe ata e kanë rritur atë si të tillë. Ata nuk e kanë regjistruar ende në shkollë - kryesisht sepse kanë frikë se fëmija i tyre nuk do të pranohet sepse nuk ka dokumente identifikimi. Ata thonë se kjo nuk është çështje e shtetësisë, por është çështje e regjistrimit të lindjes. Por Eni mbetet në rrezik për të qenë pa shtetësi, viktimë e paragjyqimeve sociale dhe familjare.

Tana është një grua rome që vjen nga një qytet në Shqipërinë Juglindore. Ajo është e martuar me dy fëmijë. Ajo kurrë nuk është regjistruar sepse nëna e saj ka lindur jashtë sallës të maternitetit. Ajo jetonte jashtë vendit për shumë vite dhe ka përdorur dokumente të rreme. Jeta e saj ka qenë shumë e vështirë dhe askush nga familja e saj kurrë nuk ka arritur të regjistrojë lindjen e saj.

Fatime është një grua gjashtëdhjetë e katër vjeçare rome nga një qytet në Shqipërinë e mesme. Ajo është gjyshja e dy fëmijëve të moshës shtatëmbëdhjetë e katërmëdhjetë vjeç. Nipërit e mbesat e saj kanë lindur jashtë martesë. Babai kurrë nuk e pranoi atësinë e tyre. Fëmijët kanë lindur në Francë ku vajza e Fatimes jetonte për shumë vite. Pasi vajza e Fatimes u kthye në Shqipëri me fëmijët e saj disa vite më parë, ajo vdiq në një aksident. Fatime i mori fëmijët nën kujdesin e saj. Tani ata jetojnë në Shqipëri dhe Fatime po përballet me vështirësi në regjistrimin e tyre. Ajo arriti të siguronte disa dokumenta nga Franca, por zbuloi që vajza e saj kishte përdorur një identitet të rremë. Prandaj, Fatime nuk mund ta provojë lidhjen e saj me fëmijët, pasi autoritetet kërkojnë dokumente të vlefshme. Fatime merr përkrahje sociale por zyrtarët e kanë paralajmëruar se nëse ajo nuk i regjistron fëmijët, ata do të pezullojnë pagesat e ndihmës ekonomike.

2. Hyrje

Historitë e të intervistuarve të paraqitura më lart tregojnë thelbin e shkaqeve dhe ndikimin (rrezikun) e pashtetësisë midis romëve në Shqipëri dhe çështjeve ndër breza që ajo ngre me pasojat e saja për fëmijët. Qëndrimet diskriminuese të zyrtarëve dhe sistemeve të ngurta burokratike luajnë një rol, sikurse edhe migracioni i parregullt i shqiptarëve në Greqi dhe vende të tjera dhe dështimi i autoriteteve shqiptare për të adresuar sfidat e dokumentacionit që dalin. Mungesa e dokumentacionit shkakton vështirësi për romët e prekur që të vërtetojnë se janë shqiptarë, gjë që mund të rezultojë që fëmijëve të tyre t'u mohohen dokumentet dhe të drejtat e shtetësisë.

Ndërsa, në përgjithësi, diskriminimi dhe marginalizimi i popullsisë rome në Shqipëri ka marrë disi vëmendje, ka më pak ndërgjegjësime apo informacion mbi rrezikun e pashtetësisë, si është shkaktuar dhe nëse ka një ndikim shtesë diskriminues mbi të drejtat e romëve. Rrjedhimisht, ky raport, i cili bazohet në hulumtimin në terren të kryer në vitet 2016-2017, shqyrton lidhjen ndërmjet pashtetësisë dhe diskriminimit me të cilën ballafaqohen romët në Shqipëri. Raporti thekson rëndësinë e njohjes dhe trajtimit të diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë me të cilin ballafaqohen romët, dhe duke u përballur me qëndrimet dhe stereotipet paragjyquese që minojnë barazinë e tyre. Gjithashtu, raporti zbulon sfida të ndryshme që mund të adresohen përmes një ndërgjegjësimi më të madh, duke bërë ndryshime të vogla të politikave dhe duke shqyrtuar qëndrimet paragjyquese me të cilat ballafaqohen romët kur takohen me autoritetet shtetërore.

Ky raport është një nga rezultatet e një projekti kërkimor dhe avokimi të Qendrës Evropiane për të Drejtat e Romëve (*European Roma Rights Centre - ERRC*), Institutit për Pashtetësi dhe Përfshirje (*Institute on Statelessness and Inclusion - ISI*) dhe Rrjetit Evropian mbi Pashtetësinë (*European Network on Statelessness - ENS*) në bashkëpunim me organizatat partnere në Shqipëri (Shërbimi Ligjor Falas Tiranë - *Tirana Legal Aid Society*), Bosnie dhe Hercegovinë (Vaša Prava), Kosovë (Qendra për Ndhimë Ligjore dhe Zhvillim Rajonal - *Centre for Legal Aid and Regional Development*), Maqedoni (Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas - *Macedonian Young Lawyers Association*), Mali i Zi (Mladi Romi), Serbi (Praxis) dhe Ukrainë (Desyate Kvitnya), i cili synon të kuptojë më mirë dhe të adresojë pashtetësinë e Romëve në vendet kandidatë dhe fqinje të Bashkimit Evropian. Veçanërisht, raporti synon të kontribuojë në:

1. Forcimin e të kuptuarit të pashtetësisë Rome në vendet ku është bërë kërkimi; shkaqet e saj dhe pengesat që qëndrojnë në rrugën e zgjidhjeve;
2. Forcimin e të kuptuarit, qëndrimeve dhe kapacitetit të OJQ-ve dhe aktivistëve të të drejtave të romëve për t'u mobilizuar në mënyrë efektive për t'i dhënë fund pashtetësisë së romëve; dhe
3. Fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, rajonal (BE, Këshilli i Evropës dhe OSBE) dhe përgjigjet kombëtare ndaj pashtetësisë Rome.

Dy rezultatet e tjera të projektit plotësojnë këtë raport. Një raport tjetër kombëtar i cili shqyrton situatën në Ukrainë dhe një raport nën-rajonar që fokusohet kryesisht në vendet e Ballkanit

Perëndimor të Bosnje dhe Herzegovinës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, me informacione shtesë nga Shqipëria, Kosova dhe Ukraina. Raporti nën-rajonat sintetizon hulumtimin e bërë në 2016 dhe 2017 mbi diskriminimin dhe pashtetësinë në këto vende dhe nxjerr çështjet kryesore që kërkojnë vëmendje të mëtejshme, duke përcaktuar një sërë rekomandimesh për aktorët kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.²

2.1. Metodologjia

Hulumtimi për këtë raport u krye nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë³, përmes kërkimeve të dokumentacioneve duke përfshirë një analizë të gjerë të literaturës ekzistuese, identifikimit të aktorëve dhe intervistave gjysëm të strukturuar cilësore me romët të cilët janë pa shtetësi ose në rrezik të pashtetësisë dhe aktorë të tjerë kryesorë, duke përfshirë agjencitë ndërkombëtare, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, OJQ-të, grupet e të drejtave të romëve, zyrtarët qeveritarë, mediat dhe akademikët.

Të intervistuarit romë i folën ekipit hulumtues për përvojat dhe betejat e tyre në lidhje me mungesën e dokumentacionit dhe (rrezikun e) pashtetësinë. Janë kryer 14 intervista (me individë dhe familje), në të cilat u diskutuan arsyet e situatës së tyre dhe pasojat, si materiale dhe emocionale. Të intervistuarit ishin kryesisht të papunë, që jetonin në varfëri dhe kishin akses shumë të kufizuar në arsimim formal. Shumica prej tyre kishin emigruar në mënyrë periodike për të mbajtur veten, nëpërmjet punës së rastësishme ose lypjes. Pothuajse të gjithë të intervistuarit raportuan se hasnin pengesa serioze në lidhje me aksesin në arsim për fëmijët e tyre. Disa prej tyre ishin përballur me mundësinë e mos lejimit të frekuentimit të shkollës, nëse nuk paraqitnin një dokument identifikimi ose një çertifikatë lindjeje. Shumë nga të intervistuarit jetonin jashtë Tiranë, por disa banonin në Tiranë. Për të mbrojtur konfidencialitetin e pjesëmarrësve në hulumtim, të dhënat nga intervistat janë anonime.

Për më tepër, katërmbëdhjetë intervista u zhvilluan me aktorë të tjerë kryesorë, duke përfshirë zyrtarë të qeverisë shqiptare, aktivistë socialë, organizata rome, OJQ-të dhe agjencitë e OKB-së.

Është e rëndësishme të pranojmë në fillim disa nga kufizimet e hulumtimit. Projekti e konsideron situatën e grupeve të ndryshme të njerëzve, të përfshirë këtu nën termin “romë”, të cilët janë të ndryshëm dhe midis të cilëve linjat ndarëse nuk janë gjithmonë të qarta. Identifikimi i pashtetësisë është gjithashtu shumë kompleks dhe karakteristikat ose rrethanat që mund ta vënë dikë në rrezik të pashtetësisë janë të vështira për t’u përgjithësuar. Në mënyrë të veçantë, hulumtimi përfshin ata të cilëve u është mohuar dokumentacioni, të cilët janë në prag rreziku

2 ISI, ENS, ERRC, *Romët Përkasin - Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë*, Tetor 2017. Mund ta gjeni në <http://www.errc.org/cms/upload/file/roma-belong.pdf>; Desyate Kvitnya, ISI, ENS, ERRC, *Romët Përkasin - Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ukrainë, së shpejti* (2018). Mund ta gjeni në <http://www.errc.org/article/roma-belong--statelessness-discrimination-and-marginalisation-of-roma-in-ukraine/4616>.

3 Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (*Tirana Legal Aid Society*) është një organizatë jo-fitim prurëse Shqiptare. Për më shumë informacion rreth aktiviteteteve të saj mund të vizitoni: <http://www.tlas.org.al/en/about-tlas>.

të pashtetësisë, por që nuk mund të jenë domosdoshmërisht pa shtetësi. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se ky është një studim cilësor në shkallë të vogël dhe prandaj ofron një panoramë të problemit dhe jo një pasqyrë gjithëpërfshirëse të tij. Ai identifikon çështje të ndryshme nga të cilat mund të përfitojmë hulumtime të mëtejshme si pjesë e procesit të adresimit të tyre. Qëllimi i këtij hulumtimi nuk ishte që të arrinte përfundime finale, por të hidhte dritë mbi disa nga këto çështje komplekse dhe të kuptuarit më mirë të faktorëve kontribues.

Siç është e dukshme qartë në rajon⁴, dhe në Shqipëri po ashtu, ka disa sfida të rëndësishme për të përcaktuar në mënyrë sasiore pashtetësinë tek romët. Ekzistojnë vlerësime të ndryshme, duke e bërë të vështirë për të kuptuar shtrirjen e problemit dhe adresimin e tij nëpërmjet planifikimit dhe reagimeve të politikave. Një nga arsytet e kësaj mospërputhje të madhe në të dhëna është se individët shpesh nuk guxojnë të deklarojnë veten si pa shtetësi dhe/ose si romë, pasi kanë frikë pasojat negative siç janë humbja e çfarëdo mbështetje sociale që ata kanë të drejtë të marrin ose vështirësi shtesë për të gjetur punë. Për më tepër, jo të gjithë njerëzit pa shtetësi janë regjistruar në të dhënat zyrtare, pikërisht për shkak se ata shpesh janë ligjërisht të padukshëm. Për arsye të ndryshme, shumë individë që mund të jenë pa shtetësi mund të shmangin qëllimisht regjistrimin. Kjo, për shembull, është rasti ku personat pa shtetësi jetojnë si migrant të parregullt (të paligjshëm) në një vend dhe rrezikojnë të mbahen në paraburgim ose të dëbohen nëse identifikohen.⁵

2.2. Rreth komunitetit Rom

Romët njihen si një nga pakicat etnike më të vjetra, më të mëdha dhe më të pafavorizuara të Evropës. Këshilli i Evropës vlerëson të ketë rreth 10 deri në 12 milionë romë në Evropë.⁶ Shumica e romëve kanë një shtetësi dhe numri i romëve pa shtetësi në Evropë është kryesisht i panjohur, pasi përgjithësisht mungojnë të dhënat e ndara, veçanërisht në vendet që nuk janë anëtare të BE-së.⁷

Termi ‘romë’ zakonisht përfshin një shumëllojshmëri të gjerë të grupeve, me identitete “komplekse dhe shumë shtresor”⁸. Ka gjithashtu edhe njerëz që nuk identifikohen si romë fare - si Ashkali dhe Egjiptian - të cilët po ashtu janë objektiv i anti-xhipsizmit.⁹ Për qëllimet e këtij

4 ISI, ENS, ERRC, *Romët Përkasin - Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë*, Tetor 2017. Mund ta gjeni në: <http://www.errc.org/cms/upload/file/roma-belong.pdf>.

5 De Verneuil M, *Pashtetësia e Romëve në Ballkanin Perëndimor: Neglizhencë apo Diskriminim?*, Tezë doktore, 2016, faqe 49. Mund ta gjeni në: http://fnasat.centredoc.fr/opac/doc_num.php?explnum_id=940.

6 Këshilli i Evropës, *Fjalor përsbkrues i termave lidhur me çështjet e romëve*, 2012, faqe 6. Mund ta gjeni në: <https://rm.coe.int/1680088eab>.

7 Integrimi i Romëve 2020, *Romët në Rajon, Madhësia e Komunitetit Rom në Rajon*. Mund ta gjeni në: <http://www.rcc.int/romaintegration2020/pages/3/roma-in-the-region>.

8 Këshilli i Evropës, *Fletë informuese mbi Kulturën Rome*. Mund ta gjeni në: <http://romafacts.uni-graz.at/index.php/culture.1>.

9 Aleanca kundra Anti-xhipsizmit (*Alliance against Antigypsyism*), *Anti-xhipsizmi: një kumtesë referuese*, 2016. Mund ta gjeni në: <http://antigypsyism.eu/wp-content/uploads/2017/07/Antigypsyism-reference-paper-16.06.2017.pdf>. Shënim i përkthyesit: Për qëllimin e këtij raporti është rënë dakord me autorët që termi i përdorur në gjuhën angleze ‘antigypsyism’ të përkthehet në gjuhën shqipe si ‘antixhipsizëm’.

raporti, si dhe për “Romët Përkasin – Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë”¹⁰, termi ‘Romë’ përdoret për të përfshirë të gjitha grupet në vend, të cilat janë subjekt i anti-xhipsizmit, në përputhje me përkufizimin e Këshillit të Evropës¹¹, dhe e adopduar zakonisht nga organizatat ndërkombëtare në dekadën e fundit. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se jo të gjithë anëtarët e këtyre popullatave bien dakord për përdorimin e vetëm të këtij autonomi të standardizuar.¹²

Romët konsiderohen gjerësisht si një nga komunitetet më të marginalizuara të Evropës. Ata përjetojnë diskriminim dhe mungesë të të drejtave në forma të ndryshme, duke përfshirë brutalitetin e policisë, shkollimin e veçuar dhe mohimin e së drejtës për punë.¹³ Të dhënat e grumbulluara nga vendet pjesëmarrëse në Dekadën e Përfshirjes së Romëve (2005-2015) të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal të BE-së treguan se romët vazhdojnë të jetojnë në kufijtë e shoqërive në Evropë, me varfëri, pabarazi, diskriminim, strehim nën standard dhe shkallë të lartë të papunësisë në masë¹⁴, dhe se në krahasim me jo-romët situata e tyre mund të jetë shumë më e keqe në të gjitha fushat e jetës.¹⁵ Në disa vende, gjithashtu, është regjistruar një rritje në gjuhën e urrejtjes anti-rome dhe krimeve të urrejtjes gjatë viteve të fundit.¹⁶

Përshtatur nga **Romët Përkasin – Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë**

2.3. Diskriminimi dhe pashtetësia

Askush nuk mund të tregojë historinë e pashtetësisë, as të kërkojë t'i japi një fund të mirë asaj, pa trajtuar pabarazinë dhe diskriminimin me të cilën ballafaqohen protagonistët e saj ... pashtetësia nuk mund të çrrënjoset vetëm nëse qëndrimet diskriminuese shoqërore, të cilat i shobin disa njerëz si më pak të denjë se të tjerët për përfshirje, do të trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse.¹⁷

10 ISI, ENS, ERRC, *Romët Përkasin - Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë*, Tetor 2017.

11 Këshilli i Evropës, Romët dhe Grupet Lëvizëse, <http://www.coe.int/en/web/portal/roma>.

12 Këshilli i Evropës, *Fletë Informuese mbi Historinë e Romëve: Hyrje e Përgjithshme*. Mund ta gjeni në: <http://roma-facts.uni-graz.at/index.php/history/general-introduction/general-introduction>.

13 ERRC, *Komentet me shkrim për sqyrtim nga Komisioni Evropian lidhur me Përfshirjen e Romëve në Raportet e Progresit 2016 të vendeve të Ballkanit Perëndimor*, 2016. Mund ta gjeni në: <http://www.errc.org/cms/upload/file/ec-submission-on-roma-inclusion-in-the-western-balkans-july-2016.pdf>.

14 Sekretariati i Fondacionit Dekada e Përfshirjes së Romëve, *Indeksi i Përfshirjes Rome 2015*, 2015. Mund ta gjeni në: <http://www.rcc.int/romaintegration2020/files/user/docs/Roma%20Inclusion%20Index%202015.pdf>.

15 *Ibid.*

16 Komunikatë e Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, *Raport mbi zbatimin e Kornizës së BE-së për Strategjitë Kombëtare të Shteteve për Romët 2015 COM(2015) 299*, 17 Qershor 2015, faqe 9. Mund ta gjeni në: http://ec.europa.eu/justice/discrimination/files/roma_communication2015_en.pdf.

17 De Chickera A dhe Whiteman J, *Trajtimi i pashtetësisë përmes të drejtave për barazi dhe mospashtetësi*, në van Waas L dhe Khanna M (eds), *Zgjidhja e Pashtetësisë*, Wolf Legal Publishers, 2016, faqe 100.

Një person pa shtetësi - është dikush që *“nuk konsiderohet si shtetas nga ndonjë shtet në bazë të operimit të ligjeve të tij”*.¹⁸ Siç është përcaktuar tashmë në raportin “Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë”¹⁹, ka shumë shkaqe të pashtetësisë të njohura gjerësisht dhe një vështrim më i ngushtë në secilin prej tyre zbulon se diskriminimi shpesh luan një rol të madh.²⁰ Për më tepër, sa i përket lidhjes ndërmjet praktikave administrative, dokumentacionit dhe diskriminimit është vërejtur se *‘praktikat e këqija administrative shpesh mundësojnë diskriminimin dhe paragjykimin duke u bërë determinues nëse një person do të njihet si shtetas’*, veçanërisht aty ku zyrtarët kanë diskrecion në vendimmarrje.²¹ Shpesh janë grupet vulnerabel të cilët janë të përjashtuar, pashtetësia e tyre është një justifikim për përjashtimin e tyre të vazhdueshëm. Së fundi, forma më delikate e diskriminimit që është ngritur nga grupet e pafavorizuara socio-ekonomike me vështirësi në aksesin e zyrave administrative të centralizuara dhe duke u ndikuar në mënyrë joproporcionale nga mungesa e dokumentacionit është një tjetër shkak i zakonshëm i pashtetësisë.²²

Kjo është e rëndësishme në kontekstin e pashtetësisë Rome në Shqipëri, ku shkak kryesor i (rrezikut) të pashtetësisë është mungesa e dokumentacionit civil dhe trashëgimi i pashtetësisë. Siç shtjellon ky raport, romët ndikohen në mënyrë joproporcionale nga këto shkaqe për shkak të cenueshmërisë dhe margjinalizimit të tyre, si dhe sepse përkatësia e tyre ka më shumë gjasa të merret në pyetje nga autoritetet.

Përveç shkaktimit të pashtetësisë, diskriminimi mund të vazhdojë të minojë gëzimin e të drejtave të personave pa shtetësi. Në rastin e romëve, një pakicë që tashmë vuan nga diskriminimi dhe përjashtimi, mund të jetë e vështirë të përcaktohet se si diskriminimi në bazë të pashtetësisë së tyre i shtohet kësaj përvoje të përgjithshme. Sidoqoftë, shpesh ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë mes mungesës së dokumentacionit dhe pashtetësisë nga njëra anë dhe barrierave për të pasur akses në të drejtat themelore duke përfshirë kujdesin shëndetësor, arsimin dhe të drejtën për të punuar dhe lëvizur lirshëm nga ana tjetër. Trajtimi i pashtetësisë rome nuk do të zgjidhë të gjitha problemet me të cilat ballafaqohen romët, por do të zhdukë një nga argumentet kryesore të krijuar për të justifikuar përjashtimin e tyre: se ata *‘nuk janë nga këtu’*.²³

Përshtatur nga **Romët Përkasin – Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë**

18 Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin e personave pa shtetësi, 360 U.N.T.S. 117, 1954, Neni 1(1).

19 ISI, ENS, ERRC, *Romët Përkasin - Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë*, Tetor 2017. Mund ta gjeni në: <http://www.errc.org/cms/upload/file/roma-belong.pdf>.

20 Ibid; ISI, *Personat pa shtetësi në botë (The World's Stateless)*, Wolf Legal Publishers, 2014, faqe 23-27. Mund ta gjeni në: <http://www.institutesi.org/worldsstateless.pdf>.

21 De Chickera A dhe Whiteman J, *Trajtimi i pashtetësisë përmes të drejtave për barazi dhe mosdiskriminim*, në van Waas L dhe Khanna M (eds), *Zgjidhja e Pashtetësisë*, Wolf Legal Publishers, 2016, faqe 104-105.

22 Duhet të theksohet se mungesa e dokumentacionit nuk është e njëjtë me pashtetësinë. Shumë qytetarë nuk kanë dokumentacion. Megjithatë, mungesa e dokumentacionit mund të çojë në pashtetësi për shkak të pamundësisë për të vërtetuar përshtatshmërinë për shtetësi.

23 ISI, ENS, ERRC, *Romët Përkasin - Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë*, Tetor 2017. Mund ta gjeni në: <http://www.errc.org/cms/upload/file/roma-belong.pdf>.

3. Romët dhe Pashtetësia në Shqipëri

3.1. Romët

Në Shqipëri ka Romë dhe Egjiptian. Romët në Shqipëri deri në kohët e fundit janë njohur vetëm si pakicë gjuhësore, një status i nivelit të dytë në krahasim me pakicat kombëtare si grekët, malazezët dhe maqedonasit. Megjithatë, pas miratimit më 13 tetor 2017 të ligjit për “*Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë*” 2017 nga Parlamenti Shqiptar²⁴, Romët në Shqipëri njihen zyrtarisht si një pakicë kombëtare.²⁵ Egjiptianët, nga ana tjetër, nuk kanë marrë statusin e pakicës kombëtare, nën arsyetimin se nuk kanë ruajtur identitetin e tyre (duke përfshirë gjuhën) dhe kanë tendencë të identifikojnë veten si shqiptarë. Të dy grupet, romët dhe egjiptianët, janë komunitete të marginalizuara dhe të përjashtuara nga shoqëria, dhe për qëllimet e këtij raporti, vetëm në rast se specifikohet, termi rom do të përdoret për të përfshirë të dy grupet. Regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 identifikoi 8,300 romë dhe 3,368 egjiptianë në Shqipëri.²⁶ Megjithatë, siç do të shqyrtohet më poshtë, këto statistika konsiderohen si një nën-përfaqësim i konsiderueshëm i popullsisë dhe nuk pranohen nga asnjëri komunitet, as nga ai rom dhe as nga ai egjiptian. Megjithatë, studime dhe vëzhgime të tjera kanë vlerësuar 18,276 deri 120,000 romë dhe mbi 200,000 egjiptianë në vend.²⁷ Dallimi në këto shifra është dramatik dhe vë në pikëpyetje bazën mbi të cilën janë bërë strategjitë qeveritare dhe planet për të siguruar përfshirjen social-ekonomike të romëve.²⁸

Në përgjithësi, romët janë të pafavorizuar dhe përjashtohen, siç dëshmohet nga të gjithë treguesit e zhvillimit. Për shembull, një studim i vitit 2014 tregoi se 48% e romëve të anketuar në mjedise urbane nuk kishin shkuar kurrë në shkollë dhe 21% kishin braktisur shkollën,

24 Ligji Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar më 13 Tetor 2017.

25 Këshilli i Evropës, *Romët njihen si një Minoritet Kombëtar në Shqipëri*, njoftim për shtyp. Mund ta gjeni në: <https://www.coe.int/en/web/portal/-/roma-recognized-as-a-national-minority-in-albania>. Siç është theksuar nga Këshilli i Evropës, kjo njohje formale shënon një arritje shumë të rëndësishme për romët në Shqipëri, duke u dhënë atyre të drejta të garantuara me ligj, gjë që rrit nivelin e mbrojtjes së tyre në krahasim me statusin e mëparshëm ligjor si një pakicë etno-gjuhësore. Këtu dalin disa të drejta pozitive, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e romëve në Shqipëri, si e drejta për pjesëmarrje të barabartë dhe efektive në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike, e drejta për arsimim në gjuhën e pakicës dhe liria e shprehjes, mendimit dhe informacionit. Romët tani janë në një pozicion më të mirë për të vazhduar përpjekjet e tyre për promovimin dhe mbrojtjen e kulturës rome si një pjesë integrale e shoqërisë shqiptare.

26 Të dhënat nga censusi mund të gjenden këtu: <http://www.instat.gov.al/al/census/census-2011/të-dhënat-e-census-2011.aspx>.

27 Shikoni për shembull, OSFA, *Censusi për popullatën rome në Shqipëri*, Prill 2014. Mund ta gjeni në: http://www.osfa.al/sites/default/files/roma_census_albanian.pdf (në shqip). Shikoni gjithashtu PNUD Shqipëri, *Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri* Shkurt 2012. Mund ta gjeni në: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/Roma%20Needs%20Assessment.pdf>.

28 Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1072 datë. 23.12.2015 dhe është publikuar në fletoren zyrtare nr. 241/2015. Planin e Veprimeve 5 vjeçar mund ta gjeni këtu: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/national-action-plan-for-integration-of-roma-and-egyptians-in-th.html>.

ndërsa ende ishin nën moshën në të cilën përfundon arsimi i detyrueshëm.²⁹ Sipas një burimi tjetër, 59% e romëve pretendojnë se nuk kanë fare arsimim formal, 19% kanë ndjekur shkollën deri në klasën e katërt, pothuajse të njëjtën përqindje kanë përfunduar 8-9 vjet të arsimit dhe vetëm 3% kanë përfunduar arsimin e mesëm.³⁰ Kjo situatë kritike në arsim është përkeqësuar më tej në lidhje me aksesin në tregun e punës. Shkalla bruto e papunësisë për romët vlerësohet në 74%³¹, ndërsa shkalla e përgjithshme e papunësisë në Shqipëri është 15%.³²

Situata e strehimit të romëve në vend karakterizohet nga kushte shumë të këqija: 15% e romëve jetojnë në kasolle, çadra ose banesa të tjera jo me tulla; 60% nuk kanë ujë të rrjedhshëm brenda mjediseve të tyre; dhe 12% të tyre u mungojnë tualetet. Shumica e romëve jetojnë në zona që kanë rrugë të pashtruara (52.2%) ose rrugë që janë në gjendje shumë të keqe (22.5%)³³ Për më tepër, situata përkeqësohet nga fakti se shumë romë nuk arrijnë të përmbushin pragun e të ardhurave të nevojshme për të pasur akses në banesat sociale ose nuk kanë qenë në gjendje të rregullojnë shtëpitë e tyre sipas ligjit të vitit 2014 për legalizimin e pronës, gjë që lejoi që “ndërtimet e paligjshme” të shkatërrohen.³⁴

Në 2017 situata është akoma kritike.³⁵ Dëbimi me forcë i romëve nga shtëpitë e tyre në periferi është një çështje veçanërisht e ndjeshme, sidomos për komunitetet rome në territorin e Bashkisë së Tiranës.³⁶ Ndërsa zhvendosja është gjoja për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre,

29 OSFA, *Censusi për popullatën rome në Shqipëri*, Prill 2014, http://www.osfa.al/sites/default/files/roma_census_albanian.pdf (në shqip). Sondazhi përfshiu vetëm romët që jetojnë në zonat urbane.

30 OSFA, *Hulumtim mbi profilin socio politik të popullatës Rome në Shqipëri*. Mund ta gjeni në: <http://www.osfa.al/publikime/hulumtim-mbi-profilin-socio-politik-te-popullates-rome-ne-shqiperi>.

31 OSFA, *Censusi për popullatën rome në Shqipëri*, Prill 2014, http://www.osfa.al/sites/default/files/roma_census_albanian.pdf (në shqip). Sondazhi përfshiu vetëm romët që jetojnë në zonat urbane. Shikoni gjithashtu, PNUD Shqipëri, *Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: një profil socio-demografik dhe ekonomik i bazuar në Censusin e vitit 2011*, Prill 2015. Mund ta gjeni në: http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/_roma-and-egyptians-in-albania--a-socio--demographic-and-economy.html.

32 PNUD Shqipëri, *Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: një profil socio-demografik dhe ekonomik i bazuar në Censusin e vitit 2011*, Prill 2015. Mund ta gjeni në: http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/_roma-and-egyptians-in-albania--a-socio--demographic-and-economy.html.

33 Shikoni ERRC, *paraqitje e ERRC në Komisionin Evropian për komponentin e zgjerimit të Kornizës Rome të BE-së*, faqe 6, Maj 2017. Mund ta gjeni në: <http://www.errc.org/cms/upload/file/submission-on-roma-inclusion-in-enlargement-countries-may-2017.pdf>.

34 Amnesty International, *Shqipëri 2015/2016*. Mund ta gjeni në: <http://www.refworld.org/docid/56d05b7b15.html>.

35 Amnesty International, *Shqipëri 2016/2017*. Mund ta gjeni në: <https://www.amnesty.org/en/countries/europe-and-central-asia/albania/report-albania/>. Amnesty International raporton se autoritetet lokale në Tiranë kërcënuan të dëbojnë me forcë mbi 80 familje - kryesisht rome dhe egjiptiane - që jetonin në zonën e Bregut të Lumit, një zonë në rrezik përmbajtjes. Autoritetet nuk arritën të japin një njoftim të përshatshëm konsultim të mirëfilltë dhe strehim alternativ. Pas ndërhyrjes nga aktivistët e strehimit dhe nga Avokati i Popullit i Shqipërisë, dëbimet u pezulluan përkohësisht në fund të Shtatorit 2017. Si pjesë e një „plani ndërhyrjeje“ të propozuar nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës, familjeve u janë dhënë disa mundësi për rivendosje. Deri në fund të vitit, mbetet e paqartë nëse të gjitha familjet do të ishin në gjendje të pranoinin risistemimin dhe nëse alternativat e ofruara ishin të përshatshme dhe të qëndrueshme.

36 Këto janë situata të përsëritura që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit, më së shumti që prekin komunitetet në Bashkinë e Tiranës, për shembull, rivendosjen me forcë të komunitetit rom që ndodhet pranë ish stacionit të trenit; zhvendosje me forcë e komunitetit rom të vendosur në ndërtesat e dikurshme të “Dekorit”; dhe rivendosjen e dhunshme të komunitetit rom të vendosur në zonën e Liqenit Artificial dhe në zonën e Selitës.

gjendja e atyre që janë dëbuar me forcë nuk është përmirësuar, por është përkeqësuar më tepër. Siç thuhet nga Avokati i Popullit:

Hetimet tona administrative kanë treguar se në të gjitha rastet, subjektet private ose publike që kanë vepruar për largimin e këtyre komuniteteve, nuk kanë vepruar në linjë me parimet dhe standardet ndërkombëtare për dëbimet me forcë, të parashikuara në aktet e rëndësishme të OKB-së, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut.³⁷

Në parim, romët duhet të kenë të drejta të barabarta për sistemin e sigurimeve shoqërore shqiptare, të kenë të drejtë të marrin strehim social, ndihmë ekonomike, arsim falas, punësim, formim profesional, kujdes shëndetësor, dokumentacion dhe çdo të drejtë që sistemi shqiptar i sigurimeve shoqërore u siguron qytetarëve të tij. Megjithatë, në realitet, ata janë të përjashtuar kryesisht nga mbrojtje të tilla dhe nuk gëzojnë barazi në terma konkret.³⁸

Diskriminimi, i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, luan një rol kritik në braktisjen e romëve në ekstremitet dhe në vënien e tyre në rrezik për të qenë pa shtetësi. Ndërkohë që diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili është më lehtë i identifikueshëm, ka të ngjarë të ketë një ndikim më të thellë në marginalizimin dhe rrezikun e pashtetësisë së romëve, format më delikate të diskriminimit të tërthortë i fshehur prapa procedurave dhe kërkesave në dukje neutrale mund të kenë gjithashtu një ndikim joproporcional mbi të drejtat e romëve, duke përfshirë edhe shtetësinë

Në të vërtetë, një sërë faktorësh të ndërlikuar, si mungesa e një vendbanimi të përhershëm, dëbimet me forcë, analfabetizmi dhe mungesa e të ardhurave të qëndrueshme, pengon regjistrimin nga romët të ngjarjeve jetësore në regjistrat civilë. Kjo sfidë, e cila është një faktor i rëndësishëm kontribues për rrezikun e pashtetësisë me të cilin ballafaqohen romët, do të shqyrtohet më nga afër në këtë raport.

Që nga qershori i vitit 2014, Republika e Shqipërisë është kandidatë zyrtare për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky status është i kushtëzuar nga zbatimi i reformave strukturore kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në këtë kontekst, Qeveria Shqiptare është angazhuar të ndër marrë reforma të thella drejt pesë prioritetëve kryesorë; (i) një trupë profesionale dhe të depolitizuar të nëpunësve civilë, (ii) një sistem gjyqësor më të pavarur, (iii) luftë kundër korrupsionit, (iv) luftë kundër krimit të organizuar, dhe (v) mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në prioritetin e pestë, qeveria ka përcaktuar si një qëllim afatshkurtër zbatimin e planit kombëtar për integrimin e romëve, duke u përqendruar, ndër të tjera, në regjistrimin civil dhe aksesin në drejtësi, arsim, kujdes shëndetësor dhe të drejtën për strehim.³⁹ Kjo kërkon që shteti të

37 Avokati i Popullit i Shqipërisë, *Raport Vjetor, Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2016* (Raport mbi veprimtarinë e zyrës së Avokatit të Popullit në Shqipëri në 2016), Prill 2017. Mund ta gjeni në: http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/RAPORTE/RAPORTE_VJETORE/Raporti_2016.pdf (në shqip).

38 Avokati i Popullit i Shqipërisë, *Raport Vjetor, Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2015, Shkurt 2016*. Mund ta gjeni në: <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/REPORT%20ENGLISH%202015.pdf>.

39 Plan i Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1072 datë. 23.12.2015 dhe është publikuar në fletoren zyrtare nr. 241/2015. Planin e Veprimeve 5 vjeçar mund ta gjeni këtu: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/national-action-plan-for-integration-of-roma-and-egyptians-in-th.html>.

shqyrtojë dhe përmirësojë performancën e tij në lidhje me shumë çështje të lidhura me këtë raport, duke përfshirë regjistrimin civil, qasjen në drejtësi, arsimin, dialogun ndërkulturor, punësimin dhe ngritjen e kapaciteteve, kujdesin shëndetësor, strehimin dhe integrimin urban dhe mbrojtjen sociale.⁴⁰ Sidoqoftë, akoma më shumë mbetet për t'u bërë.

3.2. Pashtetësia

Nëse të dhënat statistikore për romët janë të paplota⁴¹ dhe problematike, të dhënat statistikore mbi pashtetësinë janë akoma më problematike. Në mënyrë të pashmangshme, informacioni statistikor mbi romët pa shtetësi (apo në rrezik të pashtetësisë) - duke qenë konvergjenca e dy grupeve të fshehura dhe të nën-raportuara - është jashtëzakonisht i vogël. Lidhja mes mungesës së dokumentacionit dhe përfaqësimit të dobët statistikor është një çështje e rëndësishme që nxjerr në pah dhe vë në dukje diskriminimin strukturor, me të cilin ballafaqohen kjo popullsi.

Frika për identifikimin e vetes së tyre me pashtetësi dhe/ose rom dhe migrimi i shpeshtë paraqet sfida të mëtejshme për mbledhjen e të dhënave gjithëpërfshirëse për mungesën e dokumenteve të identitetit dhe/ose shtetësisë. Përveç kësaj, siç do të parashtrohet më poshtë, megjithëse legjislacioni kombëtar përmban një përkufizim të pashtetësisë⁴², ai bie ndesh me standardet ndërkombëtare dhe Shqipëria nuk ka procedurë për përcaktimin e pashtetësisë për të identifikuar dhe mbrojtur personat pa shtetësi.

Kjo do të thotë se ka pak nxitje për të regjistruar dhe monitoruar me saktësi pashtetësinë në statistikat zyrtare. Sipas të dhënave më të fundit të popullsisë të mbledhura përmes regjistrimit kombëtar të vitit 2011 dhe të përpiluara nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), në Shqipëri kishte 7,443 persona pa shtetësi.⁴³ Nga ky total, 3,874 ishin burra dhe 3,569 ishin gra. Të dhënat e pashtetësisë së UNHCR-së për vitin 2016 tregojnë një shifër prej 4,921 banorësh pa shtetësi.⁴⁴

40 Shihni gjithashtu „Fuqizimi ekonomik dhe social i romëve dhe egjiptianëve - një nxitje për përfshirjen sociale“ financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga PNUD në partneritet me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Projekti mbështet Qeverinë Shqiptare në përpjekjet e saj për të arritur objektivat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptjanëve, 2016-2020, duke promovuar respektimin e të drejtave të njeriut, integrimin gjinor dhe dialogun ndërkulturor, si parakushte për hyrjen e vendit në BE. Shikoni: http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/projects/poverty_reduction/economic-and-social-empowerment-for-roma-and-egyptians--a-booste.html.

41 Dekada e Përfshirjes së Romëve, *Raporti i Monitorimit të Shoqërisë Civile për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Integritit të Romëve dhe Plani i Veprimit të Dekadës 2012 në SHQIPËRI*, 2013. Mund ta gjeni në: http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20decade%20civil-society-monitoring-report_en.pdf. Raporti thekson se dështimi për të siguruar të dhëna të sakta statistikore nga institucionet qeveritare përfaqëson „një shembull të rëndësishëm të diskriminimit institucional të komuniteteve rome“ (faqe.9).

42 Shikoni ligjin nr. 108/2003, datë 28.03.2013 “Për të huajt”.

43 Të dhënat mbi Censin mund t'i gjeni në: http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/RA-PORTET/RAPORTET_VJETORE/Raporti_2016.pdf. Ky numër bazohet në pyetësorin e regjistrimit në lidhje me shtetësinë, dhe rrjedhimisht në përgjigjet e individëve dhe vetë perceptimin (Pyetësorin mund ta gjeni në: <http://catalog.ihsn.org/index.php/catalog/4279>).

44 UNHCR, *Tendencat globale - Zhvendosja e detyruar në vitin 2016*. Mund ta gjeni në: <http://www.unhcr.org/dach/wp-content/uploads/sites/27/2017/06/GlobalTrends2016.pdf>. Ju lutem vini re se ky është një studim bazë i

Duke folur mbi popullsinë rome pa shtetësi në vend, një përfaqësues i një agjencie ndërkom-bëtare i intervistuar për këtë raport, tha:

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të thënë që pashtetësia prek më së shumti romët. Problemi krye-sor është se shteti nuk po siguron statistika dhe nuk po mban një regjistër të veçantë për personat që rrezikojnë të jenë pa shtetësi dhe që hasin probleme me regjistrimin civil. Romët përballen me diskrim-inim të shumëfishtë dhe janë të marginalizuar. Nga ana tjetër, shteti nuk po mban përgjegjësitë e tij. Dëshira nuk mungon, por mungojnë ende veprime konkrete për të luftuar pashtetësinë dhe problemet në kategori të caktuara (probleme me regjistrimin në gjendjen civile).

Ligji shqiptar “Për statusin civil” parashikon që Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile duhet të mbajë një regjistër të veçantë për individët pa shtetësi, duke shënuar vendndodhjen e tyre në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, regjistrimi nuk i jep statusin ligjor të pashtetësisë atyre, të cilët janë të regjistruar. Për më tepër, këta persona përfshihen në të njëjtin regjistër me ata që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare. Kjo e bën të pamundur dallimin midis individëve që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare për të marrë një shtetësi tjetër dhe atyre që janë pa shtetësi. Për këtë arsye, nuk është e mundur të nxirren të dhëna të sakta, për numrin e personave pa shtetësi nga ky burim, si dhe as për të dhënat mbi arsyet e pashtetësisë së tyre. Në të vërtetë, studimet e fundit të kryera nga INSTAT, UNHCR dhe organet joqeveritare nuk japin asnjë të dhënë për numrin e personave pa shtetësi në vend.⁴⁵ Kështu thuhet edhe nga një zyrtar i qeverisë:

Nuk ka një regjistër të veçantë, që identifikon numrin e personave pa shtetësi në sistemin tonë të regjistrimit civil. Por, nuk ka pengesa për të fituar shtetësinë shqiptare, nëse fëmija lind nga prindër shqiptarë ose brenda territorit të Shqipërisë. Në kuadër të Ministrisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shtetë-sisë ka mandatin për t'u marrë me këtë çështje. Për ne është e rëndësishme të zvogëlohet numri i personave të paregjistruar dhe të përmirësohet sistemi i regjistrimit, në ato drejtime ku ne hasim vështirësi.

Siç do të qartësohet më poshtë, mungesa e regjistrimit të fëmijëve në lindje lë një numër të konsiderueshëm fëmijësh pa prova se, ku kanë lindur, cilët janë prindërit e tyre ose ku banojnë ato. Mungesa e një çertifikate lindjeje nuk tregon automatikisht mungesën e shtetësisë, por në Shqipëri si në shumë vende, duke mos pasur prova për lindjen, origjinën ose identitetin ligjor, rrit rrezikun e pashtetësisë. Në mënyrë domethënëse, fenomeni i mungesës së regjistrimit mund të kalojë nga një brez në tjetrin, pasi prindërit e parregjistruar, të cilët gjithashtu nuk kanë qëndrim të përhershëm, nuk janë në gjendje të sigurojnë shtetësinë për fëmijët e tyre.

E intervistuar ka shprehur ndikimin psikologjik negativ të dhënies së shtetësisë dhe atë çfarë duhet të kalojnë fëmijët e saj:

llogaritur si më poshtë: 7.443 minus numri i rasteve të zgjidhura në instancat administrative dhe gjyqësore ndërmjet 2011-2016. Rritja potenciale e numrit të personave në rrezik të pashtetësisë nuk konsiderohet për shkak të mungesës së të dhënave në dispozicion. UNHCR, TLAS dhe Qeveria Shqiptare kanë bërë një hartë të thellë të popullsisë në rrezik të pashtetësisë (duke përfshirë romët dhe qepujt e tjerë të prekur), e cila do të publikohet në vitin 2018.

⁴⁵ TLAS dhe ENS, *Asnjë Fëmijë nuk duhet të jetë pa shtetësi: Studim për Shqipërinë, Qershor 2015*. Mund ta gjeni në: <http://www.tlas.org.al/sites/default/files/ENS%20-%20TLAS.pdf>.

Jam jashtëzakonisht e shqetësuar. Nuk është faji im që prindërit e mi emigruan ilegalisht dhe unë nuk kam dokumente të rregullta. Kjo ndikon edhe tek fëmijët e mi. Unë nuk lindi në maternitet sepse kisha frikë. Fëmijët e mi nuk kanë lindur në maternitet dhe nuk mund të regjistrohen ashtu si unë. Nëse nuk kam një dokument të vlefshëm, as ata nuk mund të kenë një të tillë, apo jo? A është faji im që prindërit e mi emigruan ilegalisht? Unë nuk mund të udhëtoj, nuk mund të martohem me burrin tim, babanë e fëmijëve të mi.

Shpresa, grua Rome 26 vjeç

4. Standarde dhe Mekanizma të Rëndësishme Rajonale dhe Ndërkombëtare

Republika e Shqipërisë është pjesë e Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1954, lidhur me Statusin e Personave pa Shtetësi (Konventa e vitit 1954)⁴⁶ dhe Konventën e vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë, ku në të dyja ajo u bë pjesë në vitin 2003.⁴⁷ Gjithashtu, ajo është pjesë e Konventës Evropiane të Shtetësisë (ECN) të vitit 1997⁴⁸, por nuk ka hyrë në Konventën e vitit 2006 të Këshillit të Evropës për Shmangjen e Pashtetësisë në lidhje me Vazhdimin e Shtetit.

Gjithashtu, Shqipëria ka një numër të lartë të pranimit të traktateve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë relevante për parandalimin e pashtetësisë dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi. Këto përfshijnë Konventën për të Drejtat e Fëmijës (CRC), e cila është aprovuar në vitin 1991⁴⁹, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)⁵⁰, që gjithashtu hyri në fuqi në vitin 1991, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (ICERD)⁵¹ dhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)⁵², të dyja të miratuara në vitin 1993 dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD)⁵³ e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2012. Shqipëria është gjithashtu pjesë e instrumentit kryesor evropian të të drejtave të njeriut, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ECHR).⁵⁴ Detyrimet e Shqipërisë sipas këtyre traktateve shtrihen në çështjet e përfshira në këtë raport, duke përfshirë të drejtat e minoriteteve, pashtetësinë, dokumentimin dhe regjistrimin e lindjeve. Për shembull, neni 7 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës i detyron shtetet të regjistrojnë çdo fëmijë menjëherë pas lindjes dhe të sigurojë që asnjë fëmijë të mos mbetet pa shtetësi. Në mënyrë të ngjashme, Neni 5(d)(iii) i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor ndalon diskriminimin racial dhe etnik, lidhur me të drejtën e shtetësisë. Si rrjedhojë, këto traktate janë mekanizmat përkatës për të siguruar që Shqipëria të mbajë detyrimet e saj sipas ligjit ndërkombëtar.

46 Ligji nr. 9057, datë 24.4.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën lidhur me statusin e personave pa shtetësi”.

47 Ligji nr. 9059, datë 8.5.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën lidhur me statusin e personave pa shtetësi”.

48 Ligji nr. 8942, datë 19.9.2002, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për shtetësinë”.

49 Ligji nr. 7531, datë 11.12.1991, “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”.

50 Ligji nr. 7510, datë 13.8.1991, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike”.

51 Ligji nr. 7768, datë 9.11.1993, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor”.

52 Ligji nr. 7767, datë 9.11.1993, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave”.

53 Ligji nr. 108/2012, datë 15.11.2012, “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

54 Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për Ratifikimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Në përputhje me Kushtetutën Shqiptare⁵⁵, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara kanë efekt të drejtpërdrejtë në Shqipëri. Kjo do të thotë, se ata janë ligjërish të zbatueshëm, janë pjesë e strukturës së legjislacionit shqiptar, kanë përparësi ndaj ligjeve kombëtare me të cilët kanë papajtueshmëri dhe janë subjekt i zbatimit të drejtpërdrejtë në vend.

Megjithëse, nga diskutimet politike, deri në fillim të viteve 2000, mungonte në masë të madhe mbrojtja e të drejtave të romëve, në kontekstin e zgjerimit të Bashkimit Evropian, kjo çështje u bë gradualisht më e spikatur.⁵⁶ Në veçanti, me publikimin e konkluzioneve të Këshillit Evropian në dhjetor 2007⁵⁷, të drejtat dhe përfshirja e romëve u bë e rëndësishme në agjendën e BE. Në vitin 2008, Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë që njihet si “*mungesa e progresit në luftën e diskriminimit racial kundër romëve dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre në arsim, punësim, shëndetësi dhe strehim*” si në vendet candidate ashtu edhe në ato anëtare, duke i kërkuar Komisionit Evropian të zbatojë konkluzionet e Këshillit dhe të zhvillojë një kornizë evropiane për përfshirjen e romëve.⁵⁸ Në vitin 2011, Komisioni Evropian ka miratuar një kornizë të BE-së për integrimin e romëve, duke i ftuar shtetet anëtare të paraqesin Strategjinë e tyre për përfshirjen e romëve në Komision.⁵⁹

Përshtatur nga **Romët Përkasin – Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë**

Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë të përshtatshme për parandalimin dhe reduktimin e (rrezikut) të pashtetësisë. Në veçanti, në kuadër të Qëllimit nr.16 i dedikuar për promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimin e aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efektive dhe të përgjegjshme në të gjitha nivelet, synimi nr.9 kërkon që deri në vitin 2030, të ofrohet për çdo njeri një entitet ligjor, duke përfshirë dhe regjistrimin e lindjeve.⁶⁰

55 Nenet 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

56 Vermeersch P, *Mes Evropianizimit dhe Diskriminimit: Romët si një fokus i veçantë i politikës së BE- së, në Mobiliteti Rom në Evropë: Konferenca Ndërkombëtare Perspektiva Shumëdisiplinore*, 14-15 Janar 2010, University of Oxford. Mund ta gjeni në: <https://romanimobilities.files.wordpress.com/2010/01/conference-proceedings1.pdf>.

57 Përfundimet e Presidencës, Këshilli Evropian në Bruksel 14 Dhjetor 2007, Bruksel, 14 Shkurt 2008 16616/1/07 REV 1. Mund ta gjeni në: http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressData/en/ec/97669.pdf.

58 Parlamenti Evropian, *Një Strategji Evropiane për Romët*, PE 401.031 rezoluta e Parlamentit Evropian e datës 31 Janar 2008 mbi një Strategji Evropiane për Romët. Mund ta gjeni në: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P6-TA-2008-0035+0+DOC+XML+V0//EN>.

59 Komunikatë e Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve (2011), *Një Kornizë e BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritit të Romëve deri në vitin 2020*, COM(2011) 173 finalja më 5 Prill 2011. Mund ta gjeni në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX:52011DC0173>.

60 Treguesi përkatës është përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç, lindjet e të cilëve janë regjistruar në një autoritet civil, të ndara sipas moshës. Për më shumë informacion rreth Objektivatë të Zhvillimit të Qëndrueshëm, shihni: <https://sustainabledevelopment.un.org/>.

5. Ligji dhe Korniza e Politikave Kombëtare

5.1. Shtetësia

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtat themelore dhe lirinë e të huajve dhe personave pa shtetësi në territor. Në veçanti, ajo garanton të drejtën e shtetësisë për personat e lindur nga një prind shqiptar dhe mbrojtjen kundër humbjes së shtetësisë.⁶¹

Ligji për shtetësinë shqiptare përfshin dy koncepte për përfitimin e shtetësisë, *jus soli* dhe *jus sanguinis*, bazuar respektivisht në lindjen në territorin shqiptar dhe në një marrëdhënie gjaku me një shtetas shqiptar.⁶² Ndërkohë që përfitimi duhet të jetë automatik sipas ligjit⁶³, për secilin rast, në praktikë fitimi i shtetësisë jepet në bazë të regjistrimit të lindjes. Siç do të shihet më poshtë, problemet lidhur me regjistrimin e fëmijëve kanë kontribuar në mohimin e shtetësisë.⁶⁴ Për më tepër, duhet të theksohet se parimi *jus soli* është i kufizuar për fëmijët, prindërit e të cilëve janë banorë të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë.⁶⁵ Rrjedhimisht, fëmijët e prindërve që nuk kanë leje qëndrimi ose nuk kanë dokumenta, janë në rrezik të madh të pashtetësisë. Gjithashtu, rimarrja e shtetësisë është e mbyllur për ata që janë pa dokumenta dhe në rrezik të pashtetësisë. Në të vërtetë, ndërkohë që ligji shqiptar parashikon lehtësimin e rimarrjes së shtetësisë në rastin e personave pa shtetësi⁶⁶, të pa dokumentuarit, por të njohur zyrtarisht si pa shtetësi, duhet të

61 Nenet 16 dhe 19 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

62 TLAS dhe ENS, *Asnjë Fëmijë nuk duhet të jetë pa shtetësi: Studim për Shqipërinë*, 2015, faqe 5-6. Mund ta gjeni në: <http://www.tlas.org.al/en/studies>.

63 Neni 7, Ligji nr. 8442/1999, datë 21.01.1999, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8389 datë 5 Gusht 1998 „Për Shtetësinë Shqiptare” i ndryshuar.

64 Blerja dhe braktisja e shtetësisë shqiptare rregullohet me Ligjin nr. 8389 „Për Shtetësinë Shqiptare“, datë 05.08.1998, i ndryshuar nga Ligji nr. 8442, datë 21.01.1999. Ndryshimet legjislative që kanë ndodhur në vitin 1999 janë reformat më të fundit të miratuara. Në përputhje me dispozitat ligjore që përcaktojnë kriteret për përfitimin, heqjen dorë dhe ripërtëritjen e shtetësisë shqiptare, janë miratuar aktet nënligjore në vijim, të cilat përcaktojnë rregullat, afatet kohore, dokumentacionin dhe autoritetet kompetente për shqyrtimin e kërkesave të tilla:

1. Udhëzimi i Përbashkët Nr.6252, datë 10.12.2001 dhe nr.353, datë 11.27.2001 i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Rendit Publik “Për procedurat dhe dokumentacionin për blerjen, rimarrjen dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare”, i ndryshuar me udhëzim të përbashkët nr.10452 / 2, datë 26.09.2007 dhe nr.5212 / 2, datë 17.09.2007 i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme;
2. Vendimi nr.554, datë 07.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga persona me origjinë shqiptare, me përjashtim të qytetarëve të Republikës së Kosovës”;
3. Udhëzimi i Përbashkët nr. 4573/3, datë 12.07.2013 “Për procedurat, afatet kohore dhe kërkesat e dokumentacionit për njohjen e shtetësisë shqiptare, shqyrtimin e tyre dhe formën e mënyrën e plotësimit të aplikimit për marrjen e shtetësisë nga personat me origjinë shqiptare”.

65 Neni 8 Ligji nr. 8389, “Për Shtetësinë Shqiptare”, datë 05.08.1998, i ndryshuar nga Ligji nr. 8442, datë 21.01.1999 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8389 datë 5 Gusht 1998 “Për Shtetësinë Shqiptare”, “... 2. Një fëmijë i lindur në Republikën e Shqipërisë nga prindër me shtetësi të ndryshme, të cilët janë banorë të ligjshëm të Republikës së Shqipërisë, mund të fitojë shtetësinë shqiptare me pëlqimin e dy prindërve.

66 Shikoni gjithashtu Krasniqi G, *Raporti: Shqipëria*, projekti CITSEE & EUDO Citizenship Observatory, Nentor 2012, faqe 12.

aplikojnë për shtetësinë shqiptare përmes procedurës së rregullt. Megjithatë, disa nga kërkesat e përcaktuara me ligj, të tilla si qëndrimi i ligjshëm dhe i vazhdueshëm për të paktën pesë vjet ose të ardhura të mjaftueshme dhe një banesë, janë të pamundura të përmbushen.⁶⁷

Përveç kësaj, natyralizimi si shtetas shqiptar duhet të ratifikohet me dekret të Presidentit të Republikës.⁶⁸ Personi i interesuar duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar dhe Ministria e Punëve të Brendshme kontrollon dhe verifikon këto dokumente përpara dorëzimit të kërkesës tek Presidenti, për shqyrtim dhe miratim. Presidenti dhe Ministria e Brendshme kanë privilegje të ndryshme: Ministria kontrollon nëse formati i kërkesës është i saktë, por nuk ka të drejtë të vlerësojë bazën ligjore të çdo kërkesë. Vendimi, nëse një kërkesë mbështetet nga ligji, është diçka që mund ta përcaktojë vetëm Presidenti.

Një vendim i Ministrisë për refuzimin e dorëzimit të dokumentacionit tek Presidenti mund të kundërshtohet në gjykatë.⁶⁹ Shqetësues është fakti që ligji nuk siguron të drejtën e ankesës kundër dekretit të Presidentit për të dhënë shtetësinë. Megjithatë, në një rast të vitit 2002, Gjykata e Rrethit Tiranë e konsideroi veten kompetente për të vendosur mbi një dekret presidencial, që revokon nënshtetësinë e dikujt.⁷⁰ Ky rast tregon njohjen e Gjykatës që parimet kushtetuese të ‘gjykimit të drejtë’ dhe ‘të drejtës së ankesës’ mbahen në mungesë të dispozitave ligjore për të drejtën e ankesës dhe se gjykatat ende mund të shqyrtojnë rastet që kanë të bëjnë me shtetësinë. Megjithatë, është e nevojshme të ndryshohet ligji për të futur një të drejtë të qartë për të apeluar kundër dekretive presidenciale në lidhje me shtetësinë.

Së fundmi, duhet të theksohet se ligjet shqiptare sigurojnë mbrojtje specifike për foshnjët⁷¹, dhe për personat që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare, për shkak të premtimit të një shtetësie tjetër, në rast se nuk e fitojnë shtetësinë e premtuar brenda një periudhe të arsyeshme kohore.⁷²

Në vitin 1998, UNHCR-së iu besua nga Komiteti Ekzekutiv i saj dhe nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, ofrimi i shërbimeve teknike dhe këshilluese lidhur me përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit të shtetësisë për shtetet e interesuara. Pas shqyrtimit të projektligjit për shtetësinë shqiptare, UNHCR-ja vlerësoi se ishte “i një standardi të lartë dhe, në

67 Neni 9 i Ligjit “Për Shtetësinë Shqiptare” parashikon që një i huaj që ka paraqitur kërkesën për marrjen e shtetësisë shqiptare me natyralizim, do të fitojë shtetësinë shqiptare nëse i plotëson gjashtë kërkesat e mëposhtme: (i) moshën 18 vjeç; (ii) qëndrim të ligjshëm dhe të vazhdueshëm për të paktën pesë vite; (iii) të ardhura të mjaftueshme dhe një banesë; (iv) të mos ketë qenë i dënuar ndonjëherë për vepra penale; (v) njohuri bazë të gjuhës shqipe, dhe (vi) nuk përbën asnjë kërcënim për sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë.

68 Nenet 17-23 të Ligjit nr. 8389 “Për Shtetësinë Shqiptare”, datë 05.08.1998 i ndryshuar nga Ligji nr. 8442 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8389 datë 5 Gusht 1998 „Për Shtetësinë Shqiptare” – përcaktojnë procedurat.

69 Sipas Nenet 19(3) të Ligjit nr.8389 “Për Shtetësinë Shqiptare”, datë 08.05.1998 – i ndryshuar, gjykata kompetente për procedura të tilla është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

70 Vendim nr. 5139/ 23.12.2002 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

71 TLAS, *Asnjë Fëmijë nuk duhet të jetë pa shtetësi: Studim për Shqipërinë*, 2015 (ENS), <http://www.tlas.org.al/sites/default/files/ENS%20-%20TLAS.pdf>.

72 Nenet 14 dhe 24 të Ligjit “Për Shtetësinë Shqiptare”.

parim, e arrin qëllimin e shmangies së pashtetësisë⁷³. Për fat të keq, siç do të tregohet në këtë raport, ekzistojnë boshllëqe të mëdha midis kornizës ligjore teorike dhe funksionimit aktual të institucioneve shqiptare.

5.2. Barazia dhe mosdiskriminimi

Neni 18 i Kushtetutës garanton që:

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkak të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë etnike, gjubës, bindjeve politike ose filozofike, statusit ekonomike, social ose arsimor apo origjinës; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për arsyet e përmendura në pikën 2, përveç nëse ekziston një justifikim objektiv dhe racional.

Në vijim të këtij amendamenti kushtetues, në vitin 2010, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10221 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili rregullon zbatimin e këtij parimi të barazisë dhe parashikon krijimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion publik i pavarur i mandatuar për të siguruar mbrojtje kundër diskriminimit dhe çdo lloj sjelljeje që inkurajon diskriminimin.⁷⁴ Gjithashtu, ky ligj u miratua për të sjellë legjislacionin shqiptar në përputhje me direktivat përkatëse të BE.⁷⁵ Sipas ligjit kundër diskriminimit, fushat kryesore në të cilat sigurohet mbrojtja ligjore nga diskriminimi përfshin punësimin, arsimin dhe ofrimin e mallrave e shërbimeve. Për më tepër, gëzimi i të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë mbrohet nga diskriminimi. Barazia dhe mbrojtja nga diskriminimi janë të përfshira edhe në ligje të tjera. Megjithatë, nevojiten përpjekje shtesë për të zhvilluar një regjistër të rasteve anti-diskriminuese dhe për të vendosur një ligj solid kundër diskriminimit.⁷⁶

Që nga viti 2009, korniza ligjore dhe institucionale kundër diskriminimit është përmirësuar ndjeshëm në Shqipëri dhe legjislacioni në fuqi konsiderohet se është në përputhje me Direktivën

73 UNHCR, *Analizë dhe Komente mbi Draft Ligjin për Shtetësinë Shqiptare*, 21 Prill 1998 www.refworld.org/docid/3ae6b31dab.html.

74 Shikoni *Raportin e Katërt të paraqitur nga Shqipëria në bazë të nenit 25, paragrafi 2 të Komentës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*, ACFC/SR/IV(2016)005, 8 Nëntor 2016. Mund ta gjeni këtu: <https://rm.coe.int/16806befc5>. Raporti sqaron se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) ka autoritetin për të ndihmuar viktimat e diskriminimit duke shqyrtuar ankesën ose ndihmën në gjyq dhe hetimet me iniciativën e tij. Në vitin 2015, KMD ka trajtuar 288 çështje (268 ankesa dhe 20 me iniciativën e tij). Diskriminimi racor mbetet shkaku kryesor i kërkesave. Shqetësimet e parashtruara nga ankesit romë kanë të bëjnë me: mos marrjen dhe trajtimin e padrejtë në lidhje me ndihmën ekonomike; trajtim të pabarabartë në fushën e punësimit në sektorin publik dhe privat; mosrespektimi i të drejtës së tyre për strehim dhe prishjen e vendbanimeve të tyre në proces legalizimi.

75 Ky ligj është në përputhje me Direktivën e Këshillit 2000/43/EC of 29 Qershor 2000 zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë mes personave pavarësisht nga origjina racore apo etnike; Direktiva e Këshillit 2000/78/EC datë 27 Nëntor 2000 krijimi i një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion; Direktiva e Këshillit 2004/113/EC datë 13 Dhjetor 2004 zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave në aksesin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime; dhe Direktivën 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 5 Korrik 2006 mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit.

76 *Progres Raporti i Shqipërisë*, 2016, faqe 21; 57. Mund ta gjeni në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf.

Evropiane të Barazisë së Racave.⁷⁷ Megjithatë, ka pak dëshmi që tregojnë, se romët kanë përfituar si rezultat i kësaj. Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, numri shumë i vogël i ankesave konfirmon mungesën e ndërgjegjësimit të romëve për të drejtën e tyre për t'u ankuar, si dhe pamundësinë e tyre për të pasur akses juridik në sfidat e diskriminimit kundër tyre.⁷⁸

Historia e Enit

Eni është një fëmijë rom, i cili ka lindur si interseks. I lindur me karakteristika femërore dhe mashkullore, çertifikata e lindjes e Enit përcakton gjininë e fëmijës si “hemafrodit”. Lindja nuk është regjistruar në zyrën e gjendjes civile, për shkak se nuk ka asnjë formë për të regjistruar një gjini që nuk është ‘mashkull’ ose ‘femër’. Termi ‘hemafrodit’ u përdor gjerësisht nga mjekët gjatë shekujve 18 dhe 19 dhe tani konsiderohet arkaik dhe përcmues.

Për rrjedhojë, ekzistenca ligjore e Enit nuk është regjistruar ose njohur për vite - që nga lindja - për shkak të dështimeve të sistemit, si dhe stigmës sociale dhe paragjykitimit ndaj personave interseks. Në të vërtetë, edhe prindërit e Enit e kanë të vështirë të pranojnë gjininë e fëmijës:

Nuk mjaftonte të ishim romë dhe të varfër dhe me një mijë probleme, por tani duhet të merrem me një fëmijë të lindur në këtë mënyrë. Të paktën nëse mund ta regjistroja, ai mund të shkonte në shkollë ose të regjistrohej në një kurs ose spital për të pasur çfarëdo trajtimi.

Jaho, babai i Enit.

Dështimi i sistemit për të përfshirë fëmijët interseks në proceset e regjistrimit të lindjeve është diskriminuese dhe një shkelje e së drejtës së fëmijës për një identitet ligjor. Kur ky diskriminim, në bazë të identitetit gjinor përjetohet nga dikush që tashmë ballafaqohet me diskriminim në bazë të përkatësisë etnike, disavantazhi është shumë më i madh. Kjo përforcohet edhe nga mungesa e dokumentacionit dhe nga rreziku i pashtetësisë.

Identiteti gjinor i fëmijës është aktualisht në rrezik pasi prindërit e identifikojnë fëmijën si djalë dhe shohin një procedurë mjekësore si një zgjidhje për t'u marrë me këtë situatë:

“Ne duam ta operojmë atë dhe ta rregullojmë këtë problem, sepse mjekët na kanë thënë që mund të ndreqet me një operacion. Pas operacionit ai mund të regjistrohet si djalë. Tani kemi turp nëse dikush njihet me situatën e tij, prandaj kam frikë ta rregjistroj.

Donika, mamaja e Enit.

77 Direktive e Këshillit 2000/43/EC datë 29 Qershor 2000 “Mbi parimin e trajtimit të barabartë midis personave pavarësisht nga origjina racore ose etnike”.

78 Dekada e Përfshirjes së Romëve, Raporti i Monitorimit të Shoqërisë Civile për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Plani i Veprimtimit të Dekadës 2012 në SHQIPËRI, faqe 29-31, 2013. Mund ta gjeni në: http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20decade%20_civil-society-monitoring-report_en.pdf; Meçe M, Sistemi i Drejtësisë i Aksesueshëm për të Gjithë: Rasti i Minoritetit Rom në Shqipëri, ECMI, Shkurt 2015. Mund ta gjeni në: http://www.ecmi.de/uploads/tx_lfpubdb/ECMI_Working_Paper_84.pdf.

Hulumtimi i kryer për këtë raport gjeti se shumë nga aktorët kyç të intervistuar ranë dakord se romët kanë qenë prej kohësh viktime të diskriminimit të shumëfishtë dhe ndërsektorial⁷⁹ në Shqipëri, dhe se kjo rrit rrezikun e mohimit të dokumentacionit, duke çuar drejt pashtetësisë së tyre.

Sidoqoftë, ky problem është një problem kompleks dhe i vështirë për t'u adresuar.

Së pari, nuk ka pasur ankesa te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në lidhje me pamundësinë për të fituar shtetësinë dhe pasojat që lindin si rezultat.

Romët, të cilët janë intervistuar për këtë raport e që rrezikojnë pashtetësinë, kanë perceptuar përjashtimin e përditshëm dhe diskriminimin që ata përballen, si të lidhur ngushtë me varfërinë dhe mungesën e edukimit formal. Sipas tyre, ata nuk janë në gjendje të paguajnë për të marrë shërbime sociale, dhe kjo është arsyeja pse ata përjetojnë këtë situatë.

Së dyti, ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” nuk parashikon një zgjidhje për diskriminim të shumëfishtë dhe ndërsektorial, dhe deri më sot nuk ka pasur asnjë korrigjim gjyqësor për viktimat e këtyre formave të diskriminimit.

5.3. Pashtetësia në ligjin kombëtar

Neni 3.2 i ligjit shqiptar mbi “*Të Huajt*”⁸⁰ përcakton një person me pashtetësi si “*një person i cili nuk është qytetar i asnjë shteti*”. Ky përkufizim bie ndesh me përkufizimin e së drejtës ndërkombëtare të një personi pa shtetësi, i cili “nuk konsiderohet nënshtruar nga ndonjë shtet nën veprimin e ligjit të tij”.⁸¹ Dështimi për të përfshirë shprehjen “nën veprimin e ligjit të tij” në ligjin shqiptar është një boshllëk i rëndësishëm në përkufizim. Kjo do të thotë, se ata që në bazë ligjit duhet të kenë një shtetësi, por i është mohuar shtetësia e tyre për shkak të moszbatimit (ose zbatimit diskriminues) të ligjit, nuk mund të konsiderohen pa shtetësi në vend. Në mungesë të një procedure për identifikimin dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi, ndikimi i këtij boshllëku mund të jetë më pak i dukshëm në praktikë, por është diçka e rëndësishme, pasi mund të rezultojë që personat pa shtetësi të mos identifikohen dhe t'u mohohet mbrojtja.⁸² Hendeku në përkufizimin e identifikuar më lart, së bashku me mungesën e një procedure për përcaktimin e pashtetësisë, parandalon personat pa shtetësi të njihen si të tillë në Shqipëri dhe nga mbrojtja dhe të drejtat që ato përfshijnë, siç është e drejta për një dokument udhëtimi dhe qëndrim ligjor.⁸³

79 Për një panoramë të Diskriminimit ndërsektorial shihni për shembull, Fredman S, Rrjeti evropian i ekspertëve ligjorë për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, *Diskriminimi ndërsektorial në barazinë gjinore dhe ligjin për mos-diskriminim e BE-së*, faqe 27-28; 39-42, 2016. Mund ta gjeni në: <http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/document/files/intersectionality.pdf>.

80 Ligji nr.108/2013, datë 28.03.2013, “*Për të huajt*”.

81 Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin e personave pa shtetësi, 360 U.N.T.S. 117, 1954, Neni 1(1).

82 ENS, Mbrojtja e personave pa shtetësi nga paraburgimi arbitrar: Agjenda për Ndryshim, 2017, faqe 11, mund ta gjeni këtu: <http://www.statelessness.eu/resources/protecting-stateless-persons-arbitrary-detention-agenda-change>; UNHCR, *Manual për Mbrojtjen e Personave pa Shtetësi sipas Konventës së vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi, Gjenerë, 2014*. Mund ta gjeni në: http://www.unhcr.org/dach/wp-content/uploads/sites/27/2017/04/CH-UNHCR_Handbook-on-Protection-of-Stateless-Persons.pdf.

83 Shikoni Nenet 3(5), 16(3) dhe 38(2) Ligjin nr. 108/2013 “*Për të huajt*”.

6. Rregjistrimi i Lindjeve dhe Rreziku i Pashtetësisë

Siç u përmend më lart, ndërkohë që përfitimi i shtetësisë shqiptare duhet të jetë automatik⁸⁴, në praktikë sipas ligjit të “Statusit Civil”⁸⁵, rregjistrimi i lindjeve duhet të kryhet si një parakusht i domosdoshëm për marrjen e shtetësisë shqiptare. Kjo është një kërkesë që shumë Romë e kanë të pamundur ta përmbushin, duke i ekspozuar ato (duke u rrezikuar) ndaj pashtetësisë. Në të vërtetë, nga pjesa më e madhe e intervistave të realizuara me Romët dhe palët e tjera të interesit, shkaku kryesor (rreziku i) pashtetësisë së Romëve lidhet me sfidat, me të cilat ato përballen në aksesin ndaj rregjistrimit civil në përgjithësi dhe rregjistrimit të lindjeve në veçanti. Fëmijëve u mohohet e drejta e barabartë për shtetësinë shqiptare sepse lindjet e tyre nuk mund të regjistrohen.

Më poshtë, do të hulumtohen sfidat kryesore lidhur me procesin e regjistrimit të lindjeve, veçanërisht për ata që nuk kanë dokumentet e nevojshme (**6.1 Procedura e regjistrimit të lindjes dhe sfidat**). Nënseksioni vijues do të analizojë se si është përkeqësuar ky problem, kur fëmijët lindin jashtë vendit, veçanërisht nëse prindërit e tyre jetojnë jashtë vendit pa status ligjor. (**6.2 Legalizimi i dokumenteve të fëmijëve të lindur jashtë vendit**). Nënseksioni i fundit do të shqyrtojë boshllëqet e ndihmës juridike në sistemin shqiptar, të cilat pengojnë aksesin efektiv në drejtësi për grupet vulnerabël (**6.3 Ndihma juridike**).

6.1. Procedura e regjistrimit të lindjes dhe sfidat

Procesi i rregjistrimit të lindjeve në Shqipëri mund të jetë kompleks dhe vështirë i aksesueshëm. Ata, të cilët kanë më shumë gjasa të mos kenë akses në dokumentacion dhe rregjistrim janë fëmijët e prindërve, të cilët nuk e kanë dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kërkesave ligjore për regjistrimin civil në përgjithësi, duke përfshirë regjistrimin e lindjeve, vdekjeve, martesave, transferimeve të vendbanimeve të ligjshme, shkurorëzimeve dhe kujdestarinë e fëmijëve.

⁸⁴ Shikoni Nenin 1 të Ligjit nr. 8442/1999, datë 21.01.1999, „Për dësa ndryshime në Ligjin nr. 8389, datë 5.08.1998 „Për Shtetësinë Shqiptare”, i cili parashihet që „Neni 7 i Ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998 „Për Shtetësinë Shqiptare” ndryshohet si më poshtë: „Kushdo që ka lindur nga të paktën një prindër të shtetësisë shqiptare, merr automatikisht shtetësinë Shqiptare”.

⁸⁵ Ligji nr. 10129/2009, datë 11.5.2009, “Për Statusin Civil”.

Tabela e mëposhtme ofron një përmbledhje të sistemit dhe sfidave kryesore të tij:

Tabela A: Rregjistrimi i lindjeve

Kush mund të regjistrojë një fëmijë?	Prindi; përfaqësuesi ligjor ose kujdestari; çdo anëtar tjetër i familjes; përfaqësuesi ligjor i nënës ⁸⁶	
	Procedura / kërkesat	Sfidat
Fëmijët e lindur në spital	<ul style="list-style-type: none"> • Çertifikata e lindjes nga spitali duhet të sillet në zyrën e gjendjes civile në vendbanimin e përhershëm të prindërve • Dokument identifikimi i prindit ose personit të autorizuar për regjistrimin e lindjes • Nëna duhet të identifikohet me dokumentacion • Duhet verifikuar shtetësia dhe qëndrimi i ligjshëm i prindërve 	<ul style="list-style-type: none"> • Prindërit pa dokumenta, së pari duhet të zgjidhin çështjet e tyre të dokumentacionit: <ul style="list-style-type: none"> • të marrin certifikatat e tyre të lindjes dhe letërnjoftimet • të marrin njoftimin për lindjen nga institucioni shëndetësor ku kanë lindur • Procedura gjyqësore për vërtetimin e lindjes së prindërve <ul style="list-style-type: none"> • Kërkohet nëse prindi ka lindur në shtëpi dhe lindja nuk është regjistruar zyrtarisht • Nëse prindi nuk është i dokumentuar, procedura duhet të iniciohet nga dikush tjetër i dokumentuar dhe i “interesuar” • Dëshmi e pranuar si provë • Disponueshmëria e ndihmës juridike <ul style="list-style-type: none"> • Edhe pse e disponueshme në teori, romëve u mohohet në praktikë për shkak të mungesës së dokumenteve për të vërtetuar pranueshmërinë • Dëshmia e vendbanimit të përhershëm <ul style="list-style-type: none"> • Shumë Romë nuk jetojnë në vendbanimin e regjistruar • Shumë prej tyre nuk kanë mundësi të kthehen në vendin e banimit për të regjistruar lindjen • Shumë prej tyre nuk kanë qëndrim të përhershëm për shkak të strehimit jozyrtar dhe mungesës së dokumentacionit.

⁸⁶ Neni 40 Ligji nr. 10129/2009, datë 11.5.2009, “Për Statusin Civil”.

<p>Fëmijët e lindur jashtë spitalit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • <u>Shënim mjekësor</u> që dëshmon faktin e lindjes • <u>Certifikatën e njoftimit të lindjes</u> të lëshuar nga qendra më e afërt shëndetësore (pak ditë pas lindjes) duke përfshirë regjistrimin e nënës (bazuar në letërnjoftimin e saj) dhe vulën zyrtare • <u>Certifikata e njoftimit të lindjes duhet të merret në zyrën e gjendjes civile në vendbanimin e përhershëm të prindërve</u> 	<ul style="list-style-type: none"> • Prindërit pa dokumente duhet së pari të zgjidhin çështjet e tyre të dokumentacionit (si më sipër) • Dokumentacioni i kërkuar shtesë <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesat janë për fëmijët e lindur në institucionin shëndetësor, por me kërkesë shtesë për shënim mjekësor që dëshmon faktin e lindjes
<p>Fëmijët e lindur jashtë shtetit për prindërit shqiptarë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • <u>Certifikata e lindjes</u> nga vendi i lindjes sipas formës së parashikuar në ligjin shqiptar • <u>Dokumenti duhet legalizuar, përkthyer dhe noterizuar</u> 	<ul style="list-style-type: none"> • Procedura e legalizimit <ul style="list-style-type: none"> • Procedura komplekse shpesh të pamundura për t'u përmbushur për emigrantët pa dokumente • Status i parregullt <ul style="list-style-type: none"> • Për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe/ose statusit të parregullt, lindjet e shpeshta jashtë spitalit nuk kanë certifikatë lindjeje • Dëshmia e lindjes nuk mund të legalizohet nëse është e paplotë
<p>Fëmijët e lindur në Shqipëri nga prindër jo-shqiptarë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi kanë të drejta të barabarta të regjistrojnë lindjet si shtetas shqiptarë • Nëse janë rezidentë në Shqipëri, fëmijët kanë të drejtë të fitojnë shtetësi shqiptare 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e vendbanimit të përhershëm <ul style="list-style-type: none"> • Romët e pa dokumentuar mund të konsiderohen jo shtetas/me pashtetësi, por pa vendbanim të përhershëm, nuk mund të marrin shtetësinë shqiptare për fëmijët.

Ndërkohë që sfidat e identifikuar më lart nuk janë përjashtuese për romët, ato i prekin në mënyrë disproporcionale. Mungesa e burimeve, migrimi ekonomik, jeta në strehimin joformal dhe marginalizimi në përgjithësi, janë të gjithë faktorë që ndikojnë ndjeshëm në aftësinë e tyre për të regjistruar lindjen e fëmijëve të tyre. Më tepër, ky problem përkeqësohet nga ligji dhe korniza e politikave, gjë që e bën jashtëzakonisht të vështirë për prindërit pa dokumente dhe pa vendbanim të përhershëm të fitojnë shtetësinë për fëmijët e tyre. Prandaj, ekziston një aspekt i lidhur me brezat e ndryshëm ndaj rrezikut të pashtetësisë. Për shembull, një e intervistuar rome deklaroi:

Nëna ime u largua kur isha fëmijë. Nuk e di kush isha dhe kush jam. Unë kurrë nuk kam qenë e regjistruar edhe pse jam 35 vjeçe. Unë kam përdorur emra të ndryshëm dhe dokumentacion të rremë vetëm për të mbijetuar dhe për të krijuar një jetë. Tani që gjeta pak paqe dhe gjeta burrin tim, fëmijët e mi nuk mund të regjistrohen. Unë nuk dua që ata të kenë fatin tim të keq.

Tana, 35 vjeçare, grua rome

Pa regjistrimin e lindjeve, romët përballen me pengesa në marrjen e dokumenteve të tjera nga zyra e gjendjes civile dhe pasjen e dokumenteve të identitetit kur rriten. Për më tepër, pasi

romët kanë më pak gjasa të kenë të dhëna mbi pronësinë e pronës ku banojnë apo kontratat e qirasë për banim, duke u përballur kështu me shumë pengesa në zyrën e gjendjes civile kur ndryshojnë ose regjistrojnë vendbanimin e tyre.

Vajta në zyrën e gjendjes civile dhe më thanë të kthehesha pasi të kishta me vete dokumentet e dubura. Tre muajt e fundit kam jetuar në Tiranë dhe kam dashur të kem vendbanimin tim këtu, por ata thanë se kisha nevojë për një kontratë qiraje. Jam duke jetuar në një kasolle afër kushëririt tim, si mund të marr një kontratë?

Ilmi, 34 vjeçar, burrë rom

Në përgjithësi, autoritetet shqiptare janë të ndërgjegjshëm për sfidat, me të cilat ballafaqohen romët lidhur me aksesin në regjistrimin civil. Ka pasur iniciativa për të trajtuar këtë problem, siç është inkurajimi i regjistrimit të hershëm përmes ofrimit të mbështetjes financiare. Megjithatë, pavarësisht kësaj, aksesin në regjistrimin civil në Shqipëri është ende i pakënaqshëm dhe ekzistojnë akoma shumë raste të regjistrimit të vonuar të lindjeve të Romëve në Shqipëri.

Sipas Ministrisë së Brendshme, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, 148 fëmijë Rom kanë patur rregjistrime të vona të lindjeve dhe 500 individë romë janë pajisur me ndihmën e regjistrimit civil në vitin 2014.⁸⁷ Siç thuhet nga një zyrtar i Ministrisë:

Ne kemi vështirësi me të dhënat e romëve dhe egjiptianëve të parregjistruar. Të dhënat që kemi janë vetëm për popullsinë e regjistruar. Por kemi pasur bashkëpunim të mirë me organizatat e shoqërisë civile, për të pasur një pamje mbi incidencën e këtij problemi.

Statistikat e TLAS-së për vitin 2015 treguan 515 fëmijë të parregjistruar, nga të cilët 60% ishin romë. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2016, nga TLAS-ja u identifikuan 274 fëmijë të parregjistruar, nga të cilët 60% ishin romë. Në gjysmën e dytë të vitit 2016, organizata ndihmoi 408 fëmijë të parregjistruar, nga të cilët 270 ishin Romë.⁸⁸

Pengesa të tjera për regjistrimin e lindjeve, të cilat u identifikuan gjatë hulumtimit përfshinin:

1. Komunitetet që jetojnë në zonat rurale larg Qendrave Shëndetësore çojnë drejt lindjes së grave në shtëpi;
2. Mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimi mbi procesin e regjistrimit të Romëve;
3. Qëndrimet paragjyquese mes zyrtarëve dhe palëve të tjera të interesit rezultojnë në një mungesë bashkëveprimi në identifikimin e Romëve të parregjistruar dhe rreziqojnë pashtetësinë.

⁸⁷ Plani Kombëtar i Veprimit për Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri, Mund ta gjeni në: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/national-action-plan-for-integration-of-roma-and-egyptians-in-th.html>.

⁸⁸ Këto statistika janë nga baza e të dhënave e menaxhimit të brendshëm të rasteve të TLAS-it. Të dhënat mblidhen në bazë të vetëdeklarimit dhe të çdo dokumentacioni ligjor në dispozicion, si dhe informacione nga zyrat e gjendjes civile ose organizata të tjera në disa raste.

Disa nga të intervistuarit e përshkruan “paragjykimin e institucionalizuar kundër romëve”. Fakti që romët në Shqipëri janë një target i antixhopsizmit është mirë i dokumentuar. Në 2011, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit Racor, në Vëzhgimet Përfundimtare, shprehu shqetësimin se “anëtarët e minoritetit Rom, sidomos të rinjtë, përballen me profilizimin etnik dhe i nënshtrohen keqtrajtimit dhe përdorimit të paautorizuar të forcës nga oficerët e policisë.”⁸⁹ Gjithashtu, janë raportuar nga shoqëria civile edhe fjalimet e urrejtjes dhe incidentet e krimeve të urrejtjes. Megjithatë, sipas ECRI-së, deri në vitin 2015, policia shqiptare ka regjistruar vetëm një krim urrejtjeje me një rast të pazgjidhur përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁹⁰, dhe Gjykatat shqiptare nuk kanë përdorur kurrë Nenin 50 të Kodit Penal që parashikon dënime të shtuara për motivim racist.⁹¹

Dështimi i institucioneve qeveritare për të siguruar të dhëna të sakta statistikore për komunitetin rom⁹², si dhe tendenca për të zhvendosur përgjegjësinë nga një ministri në tjetrën dhe mungesa e punës proaktive për të përfshirë aktivitetet kryesore në këto çështje⁹³, mund të interpretohet gjithashtu si simptomë e paragjykimin të institucionalizuar kundër komuniteteve rome.

Një tregues i mëtejshëm i këtij problemi është mungesa e dukshme e besimit në mesin e romëve për institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e tyre. Në mënyrë të ngjashme me një studim të kohëve të fundit të Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore mbi ndërveprimet e romëve dhe minoriteteve të tjera me policinë në vendet anëtare të BE-së⁹⁴, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve kreu një studim mbi perceptimet e romëve për drejtësinë në Shqipëri.⁹⁵ Studimet treguan se kur Romët u pyetën përse nuk kishin kontakte me autoritetet, përgjigjet e tyre reflektuan dyshime serioze mbi drejtësinë e sistemit.⁹⁶

89 Komiteti i CERD, *Vëzhgime përfundimtare: Shqipëria*, CERD/C/ALB/CO/5-8, 14 Shtator 2011, para.15. Mund ta gjeni në: <http://www.crca.al/sites/default/files/publications/Concluding%20observations%20of%20the%20Committee%20on%20the%20Elimination%20of%20Racial%20Albania%282011%29.pdf>.

90 *Hysenaj v Shqipëri*, App. No. 78961/11 (EctHR); *Shikoni ERRC, Ndërhyrja e palës së tretë në Hysenaj v Shqipëri*, App. No. 78961/11 (EctHR). Mund ta gjeni në: <http://www.errc.org/article/hysenaj-v-albania-third-party-intervention-pending/4511>.

91 ECRI, *ECRI Raport mbi Shqipërinë (cikli i pestë monitorues)*, miratuar më 19 Mars 2015, para. 48. Mund ta gjeni: <https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/Country-by-country/Albania/ALB-CbC-V-2015-18-ENG.pdf>.

92 Dekada e Përfshirjes së Romëve, Raporti i Monitorimit të Shoqërisë Civile për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Plani i Veprimit të Dekadës 2012 në SHQIPËRI mund ta gjeni në http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20decade%20_civil-society-monitoring-report_en.pdf.

93 Isakovic Suni M, *Krahasimi i qasjeve për luftën ndaj pashtetësisë në Shqipëri dhe Serbi*, 2015. Mund ta gjeni në: <https://www.statelessness.eu/sites/www.statelessness.eu/files/2015-05-14%20Comparing%20Approaches%20Albania%20and%20Serbia.pdf>.

94 ERRC, *Ndërhyrja e palës së tretë në Hysenaj v Shqipëri*, App. No. 78961/11 (EctHR). Mund ta gjeni në: <http://www.errc.org/article/hysenaj-v-albania-third-party-intervention-pending/4511>. Në Dhjetor 2017, FRA publikoi Anketën e Dytë të Bashkimit Evropian për Pakicat dhe Diskriminimin (EU-MIDIS II). Gjetjet kryesore mund të gjeni në: <http://fra.europa.eu/en/publication/2017/eumidis-ii-main-results>.

95 Meçe M, *Sistemi i Drejtësisë i Aksesueshëm për të Gjithë: Rasti i Minoritetit Rom në Shqipëri*, ECMI, *Shkurt 2015*. Mund ta gjeni në: http://www.ecmi.de/uploads/tx_lfpubdb/ECMI_Working_Paper_84.pdf.

96 *Ibid*, faqe 17.

Një e intervistuar rome për këtë hulumtim, ka raportuar të tilla ndjesi:

Një mik i bashkëshortit arriti të rregjistronte vajzën e tij. Ai kishte emigruar në Gjermani, si prindërit e mi. Për aq sa unë kam informacion, ato nuk kishin asnjë dokument dhe pavarësisht kësaj ai arriti ta rregjistronte vajzën. Çfarë mund të them, burri im nuk njehe asnjë, ata na shohin si romë dhe thonë – 'hajde se këta nuk kaptojnë'.

Shpresa, 28 vjeçare, grua Rome

6.2. Legalizimi i dokumenteve të fëmijëve të lindur jashtë vendit

Kompleksiteti dhe sfidat që lidhen me regjistrimin e lindjeve janë përkeqësuar në rastet e fëmijëve të lindur jashtë vendit, veçanërisht për fëmijët prindërit e të cilëve jetojnë jashtë vendit në mënyrë të parregullt. Fëmijët e tillë ka të ngjarë të mos kenë të regjistruar lindjen e tyre ose të marrin vetëm një njoftim lindjeje që nuk përfshin informacionin bazë (përfshirë emrin) të kërkuar nga autoritetet shqiptare për të regjistruar lindjen e tyre. Në vitin 2014, Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, identifikoi më shumë se 200 raste të tilla.

Siç është shënuar në tabelën e mësipërme, për të regjistruar lindjen e një fëmije të lindur jashtë vendit, duhet të merret një certifikatë lindjeje nga vendi i lindjes dhe duhet të jetë në formën e parashikuar nga ligji: një akt i legalizuar, i përkthyer në shqip dhe i noterizuar. Ky dokument duhet të verifikohet nga Ministria e Jashtme dhe Ministria e Brendshme e vendit të huaj (kjo ndodh në shumicën e rasteve, por verifikimi mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin). Pastaj duhet të legalizohet në Konsullatën Shqiptare në vendin e huaj. Ky dokument duhet të përkthehet dhe përkthimi të noterizohet. Pasi përfundimit të këtyre procedurave, fëmija mund të regjistrohet në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri.⁹⁷

Kërkesat burokratike të kësaj procedure janë të tatueshme dhe shpesh të pamundura për t'u përmbushur, veçanërisht për gratë pa dokumenta që lindin në vende të huaja. Për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe statusit të parregullt, shpesh ata nuk lindin në spitale dhe prandaj nuk marrin gjithmonë certifikata lindjeje. Në rastin më të mirë, pranohen njoftimet e lindjes, të cilat nuk përmbajnë të gjitha informacionet që kërkojnë autoritetet shqiptare. Shumë prindër nuk arrijnë të trajtojnë të gjitha pengesat burokratike të lidhura me legalizimin e certifikatave të lindjes në vend të huaj dhe të kthehen në Shqipëri para se të marrin një certifikatë në formën e kërkuar nga autoritetet shqiptare. Në raste të tilla, certifikatat nuk legalizohen dhe lindjet e fëmijëve nuk janë të regjistruara në Shqipëri pavarësisht nëse prindërit janë shqiptarë. Shumë shpesh ata nuk janë në gjendje të kthehen në vendin, ku kanë lindur fëmijët për të zgjidhur çështjen, kështu që ekziston një rrezik më i lartë i pashtetësisë për këto fëmijë.

Sipas një marrëveshjeje të vitit 2012 midis TLAS-së dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, TLAS njofton Ministrinë për rastet e qytetarëve të cilët kërkojnë legalizimin e dokumenteve të tyre, por që nuk kanë mjete ekonomike ose fizike për ta kryer vetë këtë proces.

⁹⁷ Deri në janar 2017 ishte e mundur të regjistrohej lindja e fëmijës në konsullatën shqiptare në vendin e lindjes.

Ky është një shërbim falas i ofruar nga TLAS i cili u ka shërbyer mijëra përfituesve kryesisht romë, të cilët përndryshe do të mbeteshin në rrezik të pashtetësisë. Megjithatë, meqenëse ky nuk është një shërbim i drejtuar nga shteti, ka të ngjarë që të ketë një numër qytetarësh shqiptarë që janë të pafuqishëm përballë një situatë të ngjashme. Duke reflektuar mbi këtë situatë, një përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme deklaroi:

Ministria po bën çmos t'i vijë në ndihmë qytetarëve brenda rolit dhe mandatit të saj, por kjo drejtori nuk ka kompetencë për t'u marrë me pashtetësinë. Zyrat konsullore sigurojnë ndihmë për qytetarët, por kur bëhet fjalë për romët, tarifat ndonjëherë janë një pengesë që ata të përfitojnë nga shërbimet. Ministria e Brendshme duhet të bëjë më shumë për t'u marrë me këtë problem.

Ky problem është veçanërisht i rëndësishëm për fëmijët romë të lindur në Greqi, ku së pari autoritetet refuzojnë të lëshojnë një certifikatë të plotë të lindjes, për ata që jetojnë në mënyrë të parregullt në vend dhe së dyti për ta verifikuar atë për qëllime legalizimi me autoritetet shqiptare, të cilët nga ana e tyre refuzojnë të pranojnë thjesht aktet e huaja për qëllime të regjistrimit civil.⁹⁸

6.3. Ndhimja ligjore

Edhe pse Shqipëria ka adaptuar një ligj mbi “*Ndihmën Ligjore*”⁹⁹ në 2008, i cili teorikisht garanton ndihmën ligjore falas për personat, të cilët nuk mund ta përballojnë, aksesin ndaj drejtësisë mbetet një sfidë më vete për grupet vulnerabël. Popullatat në rrethana të cënueshme, duke përfshirë romët në veçanti, vazhdojnë të përjashtohen nga ndihma juridike për shkak të kufizimeve në akses, të avokatëve që ofrojnë shërbimin dhe taksave të larta gjyqësore.

Atyre që u është refuzuar dokumentacioni ose që nuk kanë qenë në gjendje të kenë akses në të, për shkak të çështjeve të identifikuar më sipër, gjithashtu përballen me pengesa për ndihmën juridike, pavarësisht rëndësisë së saj për zgjidhjen e këtyre problemeve. Sipas Ligjit për Ndhimën Juridike¹⁰⁰, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për ofrimin e ndihmës juridike, përgatitjen e akteve të nevojshme ligjore, zbatimin e tyre dhe cilësinë e ndihmës juridike të ofruar. Komisioni Shtetëror për Ndhimë Juridike, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, zbaton politikën qeveritare në këtë fushë, menaxhon buxhetin e ndihmës ligjore, përcakton kriteret për vlerësimin e cilësisë së saj dhe bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë.

Përkundër këtyre mekanizmave, ndihma ligjore falas mbetet kryesisht e paarritshme për romët më në nevojë, sepse ata nuk mund të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm, specifikisht dëshminë e banimit ose ndihmën ekonomike / të ardhurat, për të vendosur pranueshmërinë

⁹⁸ TLAS po punon aktualisht me 49 familje që janë në këtë situatë. Prej tyre, 27 janë familje rome. Në 2016, TLAS trajtoi 701 raste të regjistrimit të lindjeve, nga të cilat 450 ishin romë; 80% e tyre (360 raste) përfshinin raste të fëmijëve romë të lindur në Greqi.

⁹⁹ Ligji nr. 10039 datë 22.12.2008 “*Për ndihmën ligjore*” miundta gjëni në gjuhën angleze: http://www.eurallius.eu/pdf/13.Law%20on%20Legal%20Aid,%20promulgated%20on%2012_01_2009_en.pdf.

¹⁰⁰ *Ibid.*

e tyre në marrjen e ndihmës juridike. Për më tepër, në praktikë sistemi nuk ofron ndihmë juridike në rastet e pashtetësisë. Sipas ligjit, ndihma juridike mund të sigurohet vetëm për çështje të regjistrimit civil, ku dikush mund të provojë për romët se ata nuk mund t'i paguajnë shpenzimet e përfaqësimit ligjor dhe që marrin ndihmë sociale. Personat pa shtetësi dhe pa dokumente nuk kanë të drejtë për ndihmë sociale dhe janë ligjërisht të padukshëm/inekzistentë, nuk mund të përfitojnë nga sistemi i ndihmës ligjore. Si rezultat, ndihma ligjore për regjistrimin civil dhe rastet e shtetësisë sigurohen nga organizatat e shoqërisë civile.

Komisionit Shtetëror i mungon kapaciteti dhe burimet për ofrimin e Ndhmës Ligjore, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të drejtave të popullatës rome. Madje edhe numri i vogël i njerëzve që marrin ndihmë ligjore përballet me një rrezik real për mos përfaqësim efektiv¹⁰¹, si avokatë të ndihmës juridike me mungesë kompetencash dhe të keqpaguar.¹⁰²

6.4. Adresimi i pashtetësisë

Analiza e mësipërme tregon se pavarësisht identifikimit të sfidave të mëdha që hasin shumë romë (dhe komunitete të tjera) në Shqipëri për regjistrimin e lindjeve të fëmijëve të tyre, shteti ende nuk ka qenë në gjendje t'i zgjidhë ato.

Ka pasur disa përpjekje për të kuptuar shtrirjen e këtyre sfidave. Për shembull, UNHCR-ja dhe Zyra e Gjendjes Civile Shqiptare kanë zhvilluar dhe po zbatojnë një program të ri, i cili u lejon regjistruarve të regjistrojnë rastet e personave “të paregjistruar”, përfshirë shkaqet, dokumentacionin e humbur dhe të dhënat bazë për të lejuar ndjekjen e rastit. Sidoqoftë, ky mjet ende nuk është shfrytëzuar. UNCHR, së bashku me TLAS dhe ministrinë përkatëse të qeverisë po kryejnë gjithashtu një hartëzim të plotë të popullsisë në rrezik të pashtetësisë në Shqipëri, e cila pritet të publikohet në vitin 2018. Sigurimi i stimujve financiarë për të inkurajuar regjistrimin e hershëm të lindjes, udhëzimet e Ministrisë së Brendshme për regjistrat lokalë për të lëshuar dokumente për të gjithë qytetarët pavarësisht nëse ata kanë paguar tatimin mbi të ardhurat¹⁰³, dhe Memorandumi i Mirëkuptimit i lidhur me TLAS për të mbështetur regjistrimin e lindjeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, janë të gjitha shembuj të përpjekjeve për të adresuar sfidat e regjistrimit civil.

Sidoqoftë, iniciativa të tilla janë të pakta dhe nuk përbëjnë një përpjekje të përbashkët nga qeveria shqiptare për të zhdukur rrezikun e pashtetësisë. Për më tepër, asnjë institucion shtetëror nuk ka një mandat të qartë për të trajtuar këtë fenomen, duke rezultuar në një kuptim të pjesshëm të çështjes së pashtetësisë nga organet e qeverisë shqiptare. Autoriteti shtetëror me përgjegjësi

101 TLAS, *Raport Mbi Ndhmën Juridike Në Shqipëri (Report on Legal Aid in Albania)*, 2013. Mund ta gjeni në: <http://www.tlas.org/al/en/studies> (në shqip).

102 TLAS, *Rritja e mbrojtjes së të drejtave të të akuzuarve - Dokument politik*, Korrik 2016. Mund ta gjeni në: <http://www.tlas.org/al/en/studies>.

103 Isakovic Suni M, *Krabasimi i qasjeve për luftën ndaj pashtetësisë në Shqipëri dhe Serbi*, 2015. Mund ta gjeni në: <https://www.statelessness.eu/sites/www.statelessness.eu/files/2015-05-14%20Comparing%20Approaches%20Albania%20and%20Serbia.pdf>.

për të huajt dhe personat pa shtetësi është një njësi e veçantë në kuadër të Policisë Kufitare dhe Migracionit, ndërsa autoriteti qendror me përgjegjësi për çështjet e shtetësisë vepron nën Ministrinë e Brendshme.¹⁰⁴ Këto subjekte nuk kanë të dhëna për shkallën e problemit të pashtetësisë, përtej (nëse ka ndopak) rëndësisë së saj të drejtpërdrejtë në mandatin e tyre specifik.¹⁰⁵ Si të tilla, në përgjithësi, organet shtetërore kanë treguar pak interes për pashtetësinë:

Roli i Ministrisë së Brendshme në lidhje me pashtetësinë është shqyrtimi, verifikimi dhe dorëzimi tek institucioni i Presidentit të Republikës, për miratim të kërkesave për shtetësinë shqiptare të personave pa shtetësi dhe/ose personave që e kanë humbur ose e kanë hequr dorë, të cilët e aplikojnë në Drejtoritë Lokale të Policisë, ose në ambasadat shqiptare ku personat pa shtetësi kanë qëndrim. Së shpejti, drejtoria do të fillojë të punojë për hartimin e një ligji të ri mbi shtetësinë shqiptare, dhe pashtetësia do të jetë një nga pikat kyçe që do të përqendrojnë vëmendjen e nevojshme. Deri më tani nuk ka pasur asnjë mandat dhe vëmendje për këtë temë.

Zyrtar, Ministria e Brendshme

Dështimi i Shqipërisë për të trajtuar këto çështje përbën mos-pajtueshmëri me detyrimet e saj ndërkombëtare, për shembull, në bazë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Si pasojë, pashtetësia dhe rreziku i pashtetësisë është një problem serioz dhe real me të cilin përballen me qindra qytetarë (veçanërisht romët, por pa u kufizuar vetëm tek ata).

¹⁰⁴ Shikoni Nenet 17, 18, 19 dhe 20 të Ligjit nr. 8389 “Për Shtetësinë Shqiptare” datë 05.08.1998 i ndryshuar nga Ligji nr. 8442, datë 21.01.1999.

¹⁰⁵ TLAS dhe ENS, *Asnjë Fëmijë nuk duhet të jetë pa shtetësi: Studim për Shqipërinë*, 2015, ENS. Mund ta gjeni në: <http://www.tlas.org.al/en/studies>.

7. Margjinalizimi, Varfëria dhe Përjashtimi

Në parim, duke hequr disa përjashtime të kufizuara (të tilla si e drejta e votës), individët gëzojnë të drejtat e njeriut pavarësisht nga shtetësia e tyre ose mungesa e saj. Në praktikë, megjithatë, pashtetësia shpesh rezulton në mohimin e të drejtave themelore, duke shkaktuar vështirësi sociale dhe ekonomike dhe dobësi akute, sidomos në kombinim me diskriminimin, siç është rasti i romëve që janë pa shtetësi ose në rrezik të pashtetësisë dhe veçanërisht fëmijët e tyre.

Vështirësitë me të cilat përballen romët në regjistrimin e lindjeve të fëmijëve të tyre u diskutuan më sipër. Pa një certifikatë lindje, fëmija ka më shumë gjasa të ketë vështirësi në marrjen ose vërtetimin se ata kanë të drejtën e shtetësisë shqiptare. Gjithashtu, negativisht ndikon edhe gëzimi i një sërë të drejtave të tjera.

Personat romë të pa dokumentuar dhe pa shtetësi përballen me sfida të rëndësishme për marrjen e kartave të identitetit dhe vendosjen e vendbanimit të tyre të përhershëm. Kjo i vendos ata në një rrezik më të madh të arrestimit, paraburgimit dhe dëbimit, ushqehen me qëndrime diskriminuese dhe përjashtuese dhe shpesh rezulton që ata nuk janë në gjendje (ose të kenë ndonjë nxitje për t'u përpjekur) të marrin pjesë në jetën shoqërore dhe politike të vendit.

Sidoqoftë, duhet të theksohet se margjinalizimi është si pasojë dhe shkak i rrezikut të pashtetësisë që reciprokisht përforcojnë njëri-tjetrin. Kjo pjesë thekson, se si margjinalizimi dhe përjashtimi mund të përkeqësojnë sfidat, me të cilat përballen romët në aksesin në dokumentacion dhe që përforcohet nga (rreziku) i pashtetësisë në fusha të ndryshme të jetës si punësimi, strehimi, kujdesi shëndetësor dhe arsimit.

7.1. Aksesin në punësim

Romët, veçanërisht gratë Rome, janë ndjeshëm shumë pak të përfaqësuara në tregun e punës¹⁰⁶ dhe më shumë tek Romët ndikon papunësia afatgjatë. Shumë Romë nuk janë në gjendje të punësohen në Shqipëri për shkak të kualifikimeve të ulëta arsimore dhe të diskriminimit me të cilin ata përballen. Të jesh Rom është në vetvete disavantazh kur kërkon punë. Romët me të njëjtin nivel arsimor, moshë dhe gjini si një shqiptar kanë shumë më pak gjasa për t'u punësuar¹⁰⁷.

Mungesa e dokumentacionit dhe e shtetësisë e përkeqësojnë më tej këtë problem.

¹⁰⁶ PNUD Shqipëri, *Romët në Shqipëri*, Qershor 2012. Mund ta gjeni në: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20in%20%20Albania%20June%202012%20profile.pdf>.

¹⁰⁷ PNUD Shqipëri, *Romët në Shqipëri*, Qershor 2012. Mund ta gjeni në: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20in%20%20Albania%20June%202012%20profile.pdf>.

Shumica e Romëve e fitojnë jetesën nga puna rastësore informale në bujqësi, shërbim publik dhe ndërtim me paga shumë të ulëta¹⁰⁸. Përveç kësaj, perspektivat e Romëve të padokumentuar për të hyrë në punësimin formal përkeqësohen nga fakti se ata nuk janë të regjistruar në zyrat lokale të punësimit për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe si rezultat nuk mund të përfitojnë nga politikat e nxitjes së punësimit¹⁰⁹.

Unë do të isha shumë e lumtur nëse do të mund të regjistrosesha si punëkërkuese e papunë, ndërkohë që pres për dokumentet e identifikimit. Në këtë mënyrë, ne do të kishim më shumë shanse për të rritur të ardhurat tona. Vetëm bashkësborti im punon, por kjo nuk mjafton.

T.A. grua Rome 35 vjeç

Duke qenë të mbyllur në tregun informal të punësimit, Romët janë më të ekspozuar ndaj rreziqeve shëndetësore dhe të përjashtuar nga pjesëmarrja në skemat e sigurimeve shoqërore dhe strehimit.

7.2. Kushtet e strehimit

Siç u përmend më herët, sipas të dhënave aktuale në dispozicion, 15% e Romëve jetojnë në kasolle, tenda apo njësi të tjera banimi (jo ndërtim); 60% nuk kanë ujë të rrjedhshëm brenda shtëpive të tyre; dhe 12% të tyre u mungon tualeti. Përsa i përket infrastrukturës, shumica e Romëve raportojnë se jetojnë në zona që kanë rrugë të pashtruara (52.2%) ose që kanë rrugë në gjendje shumë të keqe (22.5%).

Shumë Romë pa dokumenta, gjithashtu nuk kanë qenë në gjendje të rregullojnë shtëpitë e tyre sipas Ligjit për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave / Ndërtimeve Informale, për shkak se ata nuk ishin në gjendje të siguronin dokumentacionin e kërkuar të pronës ose për shkak se ata jetonin në tokë publike ose strukturat të përkohshme, të cilat nuk janë të mbuluara nga ligji. Rrjedhimisht ata rrezikojnë dëbimin e detyruar si dhe prishjen e shtëpive të tyre¹¹⁰.

Romët - veçanërisht ata që nuk kanë dokumente - pothuajse gjithmonë përjashtohen nga programet e strehimit social. Shumë prej tyre nuk mund të përfitojnë nga strehimi social me kosto të ulët sepse nuk kanë burime të rregullta të të ardhurave, për shkak të kërkesave shumë të vështira burokratike (ECRI raporton se rreth 17 kushte duhet të përmbushen për t'u kualifikuar për strehim social) dhe për shkak se nuk janë të regjistruar si banorë. Përveç kësaj, dokumentet që kërkohen për të përfutur nga programet nuk janë të përcaktuara me ligj, duke

¹⁰⁸ PNUD Shqipëri, *Romët në Shqipëri*, Qershor 2012. Mund ta gjeni në: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20in%20%20Albania%20June%202012%20profile.pdf>.

¹⁰⁹ PNUD Shqipëri, *Romët në Shqipëri*, Qershor 2012. Mund ta gjeni në: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20in%20%20Albania%20June%202012%20profile.pdf>.

¹¹⁰ ECRI, *Raport mbi Shqipërinë (cikël i pestë monitorues), miratuar më 19 Mars 2015*, para. 73. Mund ta gjeni në: <https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/Country-by-country/Albania/ALB-CbC-V-2015-18-ENG.pdf>; Amnesty International, *Shqipëri 2015/2016*. Mund ta gjeni në: <http://www.refworld.org/docid/56d05b7b15.html>.

i lënë autoriteteve liri të konsiderueshme veprimi, që rezultojnë në mospërputhje të mëdha në mënyrën si zbatohen programet e strehimit social në nivel lokal¹¹¹.

Gjithashtu, siç shihet më lart, mungesa e pronësisë dhe jeta në strehim informal gjithashtu luan rol kritik në procedurën e regjistrimit të lindjes. Shumë Romë, për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe për shkak se shpesh jetojnë në banesa informale, ndeshin probleme me regjistrimin e vendbanimit të tyre të përhershëm dhe si pasojë, lindjen e fëmijëve të tyre.

7.3. Aksesit në kujdesin shëndetësor

Romët përballen me diskriminim në akses për kujdes shëndetësor. 76% e Romëve, në krahasim me 93% të jo-Romëve, janë të imunizuar ndaj poliometitit, difterisë, tetanozit dhe kollës. Ka raporte që Romët nganjëherë detyrohen të paguajnë ryshfet për të marrë trajtimin e duhur mjekësor. Shumë fëmijë në familjet e mëdha Rome vuajnë nga kequshqyerja, e cila ndikon në shëndetin e tyre të përgjithshëm dhe aftësinë për të studiuar.

Për më tepër, diskriminimi ndaj Romëve në kujdesin shëndetësor nuk lidhet vetëm me shqetësimet e përbashkëta të shoqërisë shqiptare për dhënien e ryshfetit të mjekëve dhe infermierëve, por gjithashtu merr në konsideratë shumë shembuj të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në lidhje me trajtimin e papërshtatshëm nga ofruesit e kujdesit shëndetësor, barrierat e komunikimit dhe shkeljen e të drejtave të kujdesit shëndetësor që, së bashku, e bëjnë sistemin shëndetësor dhe objektet e kujdesit shëndetësor vende armiqësore për Romët¹¹².

Një nga shqetësimet kryesore të Romëve është mungesa e kartave të sigurimit shëndetësor. Shumë Romë janë ose të papunë ose punojnë pa kontratë pune të vlefshme. Romët pa dokumenta ndikohen në mënyrë jo proporcionale në këtë drejtim. Në çdo rast ata nuk paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe nuk kanë të drejtë për përfitime. Romët që jetojnë me të ardhura të ulëta zakonisht nuk janë në gjendje të përballojnë kontributet e sigurimeve shëndetësore. Përveç kësaj, ata mund të mos jenë të vetëdijshëm për procedurat që duhet të ndiqen për të marrë një kartë sigurimi shëndetësor¹¹³.

Diskriminimi i dekurajon komunitetet Rome që të adresojnë menjëherë shqetësimet e tyre shëndetësore ose të lindin në spitale. Gratë Rome dhe Egjiptiane vazhdojnë të kenë akses të kufizuar në kujdesin shëndetësor parësor dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues dhe shpesh nuk janë të vetëdijshme për disponibilitetin e këtyre shërbimeve.

111 *Ibid*, para. 78.

112 Dekada e Përfshirjes së Romëve, *Raporti i Monitorimit të Shoqërisë Civile për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Integritetit të Romëve dhe Planit të Veprimit të Dekadës 2012 në SHQIPËRI*, 2013. Mund ta gjeni në: http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20decade%20_civil-society-monitoring-report_en.pdf.

113 Bordi i Emigracionit dhe i Refugjatëve të Kanadasë, *Shqipëri: Gjendja e romëve, përfshirë qasjen në arsim, punësim, strehim dhe shërbime sociale; trajtimi i romëve nga shoqëria dhe autoritetet (2011-Qershor 2014)*, 16 Qershor 2014. Mund ta gjeni në: <http://www.refworld.org/docid/53b13bfb4.html>.

7.4. Aksesimi në arsim dhe shkrim-lexim

Rezultatet e arsimimit të dobët dhe shkalla e ulët e shkrim-leximit shpesh rezultojnë në akses të kufizuar në punësim për Romët dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në aftësinë e tyre për të kuptuar dhe për të ndjekur procedurat burokratike në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë regjistrimin civil, ose të dinë se ku dhe nga kush të kërkojnë ndihmë. Për më tepër, edhe pse dokumentacioni në teori nuk përbën pengesë për fëmijët e pa rregjistruar që janë në gjendje të ndjekin shkollën, në praktikë i pengon ata të fitojnë diploma shkollore dhe universitare që vërtetojnë arsimimin e tyre.

Aksesimi në arsim në vend ka bërë disa përparime për Romët, në vitet e fundit. Kjo i kushtohet, ndër të tjera, një numri masash të synuara për të lehtësuar integrimin e fëmijëve Romë në sistemin shkollor kombëtar, siç është mundësia për të regjistruar fëmijët Romë në shkollë pa certifikatë lindjeje dhe vaksinimi, shpërndarjen e teksteve falas dhe vakteve falas, me anë të projektit “shkollat që ofrojnë ushqim”, ose përjashtimin e prindërve Romë nga pagesa e shpenzimeve që lidhen me ndjekjen e shkollës nga fëmijët e tyre¹¹⁴.

Pavarësisht nga të gjitha këto masa, ende ekziston një hendek midis ndjekjes së shkollës nga fëmijët Romë dhe pjesës tjetër të popullsisë. Kjo prek sidomos vajzat Rome. Siç raportohet nga Indeksi i Përfshirjes së Romëve 2015, në çdo tregues arsimi, vajzat po bëhen më keq se djemtë, shumë pak Romë po kryejnë arsimin fillor ose të mesëm dhe kjo ndarje po përkeqësohet¹¹⁵.

Sipas UNICEF Shqipëri, në vitin 2012 shkalla e braktisjes së shkollës në nivel kombëtar ishte më pak se 1%, ndërsa për fëmijët Romë ishte gati 4% dhe për fëmijët Egjiptianë 3.4%. Ky boshllëk mund të jetë edhe më i madh për shkak të drejtorëve të shkollave që nuk raportojnë çështjen¹¹⁶.

Mosbesimi në arsim, trajtimi diskriminues, distancat e mëdha ndërmjet shtëpive dhe shkollave të tyre, si dhe varfëria që i shtyn fëmijët Romë të punojnë për të kontribuar në të ardhurat e familjes, mund të shpjegojë ndjekjen e ulët të shkollës tek Romët¹¹⁷. Braktisja e arsimit gjithashtu paraqet pengesë për aksesin e plotë në arsimin e integruar cilësor për fëmijët Romë në vend¹¹⁸.

114 ECRI, *Raport mbi Shqipërinë (cikli i pestë monitorues), miratuar më 19 Mars 2015*. Mund ta gjeni në: <https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/Country-by-country/Albania/ALB-CbC-V-2015-18-ENG.pdf>.

115 ERRC, *Dorëzimi në Komisionin Evropian për komponentën e zgjerimit të Kornizës Rome të BE-së*, Maj 2017, faqe 6. Mund ta gjeni në: <http://www.errc.org/cms/upload/file/submission-on-roma-inclusion-in-enlargement-countries-may-2017.pdf>.

116 ECRI, *Raport mbi Shqipërinë (cikli i pestë monitorues), miratuar më 19 Mars 2015*, para. 61. Mund ta gjeni në: <https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/Country-by-country/Albania/ALB-CbC-V-2015-18-ENG.pdf>.

117 *Ibid*, para. 62.

118 ERRC, *Dorëzimi në Komisionin Evropian për komponentën e zgjerimit të Kornizës Rome të BE-së*, faqe 6, Maj 2017. Mund ta gjeni në: <http://www.errc.org/cms/upload/file/submission-on-roma-inclusion-in-enlargement-countries-may-2017.pdf>.

8. Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport synon të kuptojë më mirë lidhjen ndërmjet diskriminimit, mungesës së shtetësisë dhe pasojave të tij për Romët në Shqipëri, në mënyrë që sfidat e të drejtave të njeriut me të cilat përballen të mund të adresohen në mënyrë efektive dhe të ndjeshme. Raporti pasqyron disa intervista me personat e prekur dhe aktorët kyçë, për të identifikuar dhe analizuar faktorët kryesorë kontribues dhe pasojat e (rrezikun) e mungesës së shtetësisë.

Ka disa çështje themelore që kanë dalë nga hulumtimi. Së pari, ndërsa kuadri ligjor në Shqipëri është kryesisht jo-diskriminues, stereotipet negative të përhapura të Romëve vazhdojnë të dëmtojnë qëndrimet sociale dhe zyrtare ndaj Romëve. Rrjedhimisht, ekziston një model i racizmit institucional kundër Romëve, i cili reflektohet edhe në mënyrën se si perceptimi dhe ndjekja e përfshirjes së Romëve nga autoritetet shtetërore dhe nga mungesa e urgjencës për të adresuar disa prej sfidave më kritike që ndeshen në mënyrë joproporcionale nga ky komuniteti. Për më tepër, vetë korniza ligjore nuk trajton diskriminimin e shumëfishtë, një mangësi kyçe duke pasur parasysh bazat e ndryshme mbi të cilat Romët mund të përjetojnë ngacmime, paragjykitime dhe disavantazhe. Pavarësisht kësaj situatë dhe lidhjeve të dukshme, diskriminimi nuk shihet domosdoshmërisht në Shqipëri si një shkak dhe pasojë e mungesës së shtetësisë.

E lidhur ngushtë me temën e diskriminimit, është edhe ajo e aksesit në drejtësi. Romët përballen me sfida domethënëse që kanë të bëjnë me drejtësinë në Shqipëri dhe Komisioni Shtetëror për Ndihmë Ligjore ka dështuar ti sigurojë Romëve të cilëve u mohohet shtetësia dhe dokumentacioni të jenë në gjendje të kërkojnë dëmshpërblim ligjor. Ekziston një mangësi strukturore, pasi shumë Romë në këtë situatë nuk kanë dokumentacionin që u kërkohet të tregojnë për të vërtetuar se kanë të drejtën e tyre për të përfituar ndihmë ligjore. Ky është një dështim i madh burokratik, sa padrejtësia që këta Romë mund të përballen, është kjo mungesë dokumentacioni. Një sfidë e dytë ka të bëjë me burimet e varfra të Komisionit, që do të thotë se edhe ata që janë në gjendje të marrin ndihmë ligjore marrin shërbime me cilësi të ulët.

Një sfidë e tretë lidhet me hendekun mes kornizës ligjore të Shqipërisë (duke përfshirë detyrimet e saj ndërkombëtare që kanë forcën e ligjit) dhe burokracinë që ka për detyrë të zbatojë ligjin dhe të garantojë të drejtat. Detyrimet e ligjit ndërkombëtar dhe kombëtar të Shqipërisë në lidhje me mos-diskriminimin, regjistrimin e lindjeve, të drejtën për shtetësi, parandalimin e mungesës së shtetësisë, identifikimin dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi dëmtohen të gjitha nga një kornizë e papërshtatshme e politikave dhe një burokraci e rëndë. Në të vërtetë, është e drejtë të thuhet që mungesa e shtetësisë nuk njihet si një çështje e rëndësishme nga autoritetet dhe palët e interesuara në Shqipëri. Është domethënëse që nuk ka një njësi shtetërore me mandat për të trajtuar mungesën e shtetësisë. Megjithëse, Drejtoria për Shtetësinë dhe Drejtoria e Gjendjes Civile janë autoritetet përkatëse që merren me dhënien e shtetësisë, pak vëmendje i është kushtuar parandalimit dhe reduktimit të mungesës së shtetësisë dhe mbrojtjes së të drejtave të Romëve pa shtetësi.

Shumë nga procedurat burokratike dëmtojnë në mënyrë joproporcionale Romët, pasi nuk i përshtatin rrethanat e tyre specifike në mënyrën e duhur. Ky diskriminim i tërthortë rrit pengesat në dokumentimin dhe regjistrimin e lindjeve me të cilat ballafaqohen Romët; nuk ka zgjidhje burokratike për të adresuar situatën e mungesës së dokumentacionit dhe vendbanimit të përhershëm me të cilin jetojnë shumë Romë, të cilët sipas sistemit aktual janë të dënuar që t'ua kalojnë fëmijëve. Gjendja e fëmijëve Romë të lindur jashtë vendit ilustron ngatërresën e burokracisë, e cila nuk respekton parimet themelore të mosdiskriminimit dhe interesat më të mira të fëmijës, për të siguruar që fëmijët të mos ndëshkohen ose të jenë të pafavorizuar si rezultat i vendosjes së kërkesave që nuk mund të plotësohen nga prindërit e tyre.

Një sfidë e katërt lidhet me të metat e të dhënave që kanë të bëjnë me mungesën e shtetësisë dhe popullsinë Rome. Kjo mungesë e të dhënave është simptomë e padukshmërisë që shoqëron diskriminimin strukturor. Ajo e përkeqëson më tej problemin në fjalë, e bën më të vështirë planifikimin e një reagimi të përshtatshëm të politikave dhe e bën më të lehtë të mohohet shkalla apo serioziteti i çështjes. Në të vërtetë, ligji shqiptar nuk parashikon identifikimin dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi. Si rezultat, ata janë të cënuar në të gjitha fushat e jetës dhe ballafaqohen me pengesa në gjetjen rezidencës së ligjshme. Megjithëse Shqipëria ka të dhëna të forta ndërkombëtare të pranimit të traktateve dhe një kornizë të arsyeshme ligjore (me disa boshllëqe të mëdha), këto norma dhe standarde kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare nuk zbatohen në mënyrë universale dhe të barabartë për të mbrojtur Romët nga diskriminimi dhe mungesa e shtetësisë.

Sfida e dokumentacionit civil dhe regjistrimi i lindjeve është sfida më e madhe me të cilën ballafaqohen romët (dhe komunitetet e tjera) në Shqipëri, gjë që rrit rrezikun e mungesës së shtetësisë. Është e rëndësishme që të bëhet një dallim i qartë mes mungesës së regjistrimit civil (dhe / ose pa dokumenta) dhe pashtetësisë. Sidoqoftë, është po aq e rëndësishme të jemi të ndërgjegjshëm për rrezikun e rritur të mungesës së shtetësisë me të cilin ballafaqohen personat pa dokumente dhe fëmijët e tyre, veçanërisht kur nuk kanë vendbanim të përhershëm. Këto tema të përbashkëta kanë të bëjnë me sfidat specifike të diskriminimit me të cilat ballafaqohen komunitetet dhe individët Romë dhe me një sfidë të përgjithshme burokratike ndaj qeverisjes efektive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. E rëndësishme është që nga trajtimi i këtyre çështjeve strukturore do të përfitonin jo vetëm Romët, por shoqëria në tërësi.

Rekomandime

Duke u bazuar në gjetjet e kërkimit të paraqitura në këtë raport, bëhen këto rekomandime:

1. **Pajtueshmëria me detyrimet ndërkombëtare.** Qeveria shqiptare duhet të sigurojë që të gjitha detyrimet ndërkombëtare dhe rajonale në lidhje me të drejtën e shtetësisë, parandalimin dhe reduktimin e mungesës së shtetësisë, mbrojtjen e personave pa shtetësi, mosdiskriminimin dhe regjistrimin e lindjeve, janë plotësisht të përfshira në ligjet e vendit dhe zbatohen në praktikë. Në veçanti, Shqipëria duhet të hartojë një procedurë

në ligj për të identifikuar dhe mbrojtur personat pa shtetësi në përputhje me Konventën e vitit 1954 dhe Manualin e UNHCR-së për Mbrojtjen e Personave pa Shtetësi.

2. **Aksesi në të drejtat themelore.** Qeveria shqiptare duhet të ndër marrë hapa për të garantuar aksesin (në ligj dhe praktikë) për të drejtat themelore për të gjithë Romët në territorin e tyre, pa marrë parasysh dokumentacionin ose statusin e nënshtetësisë, duke përfshirë arsimin, kujdesin shëndetësor (përfshirë të drejtat riprodhuese dhe kujdesin e lindjes për gratë), punën, lirinë e lëvizjes, lirinë dhe sigurinë e personit, pjesëmarrjen e barabartë në jetën shoqërore dhe politike dhe lirinë nga shkeljet e të drejtave, si martesë e hershme dhe martesë që në fëmijëri.
3. **E drejta për një shtetësi dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm.** Qeveria shqiptare duhet të ndërmarrë hapa për të reformuar ligjin dhe praktikën që pengon gëzimin e shtetësisë shqiptare nga ata që kanë të drejtë ta kenë atë. Në veçanti, Shqipëria duhet të mbrojë të drejtën e çdo fëmije për shtetësi, pavarësisht nga statusi, dokumentacioni ose veprimet e prindërve të tyre. Kjo duhet të integrohet në punën e Qeverisë drejt Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm, për të siguruar që “askush të mos lihet prapa” në zbatimin e Synimit nr.16.9 deri në vitin 2030, të sigurojë identitetin ligjor për të gjithë, duke përfshirë regjistrimin e lindjeve”.
4. **Trajtimi i paragjyqimit dhe diskriminimit.** Qeveria shqiptare duhet të veprojë për të trajtuar diskriminimin strukturor ndaj Romëve, duke përfshirë qëndrimet paragjyquese dhe stereotipet negative, për të siguruar që Romët të mos diskriminohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në aksesin e tyre në dokumentacion, gëzimin e të drejtës së tyre për një shtetësi dhe të të drejtave të tjera të njeriut. Qeveria duhet të sigurojë që kuadri ligjor shqiptar të jetë i pajisur për të identifikuar dhe parandaluar diskriminimin e shumëfishtë me të cilin ballafaqohen Romët pa shtetësi.
5. **Aksesi në regjistrimin civil.** Qeveria shqiptare duhet të sigurojë që të gjitha procedurat e regjistrimit civil dhe dokumentacionit, duke përfshirë regjistrimin e lindjeve, të jenë të aksesueshme për të gjithë, duke thjeshtuar procedurat komplekse dhe duke eliminuar pengesat që lidhen me koston, kohën, distancën dhe burokracinë. Duhet të krijohet një sistem qendror dhe i kompjuterizuar i regjistrimit për të mundësuar regjistrimin automatik të lindjeve nga institucionet shëndetësore, për të lehtësuar zgjidhjen efikase të rasteve përmes shkëmbimit të informacionit nëpër zyrat e ndryshme të regjistrimit për numrin e njerëzve të prekur nga problemet e regjistrimit dhe veprimet e nevojshme për t'i korrigjuar ato.
6. **Fëmijët e lindur jashtë vendit.** Qeveria shqiptare duhet të forcojë bashkëpunimin me shtetet e tjera për çështjen e regjistrimit të lindjeve për shtetasit shqiptarë, fëmijët e të cilëve janë të lindur jashtë vendit. Duhet të përmirësohet puna e përbashkët ndërmjet Ministrive të Punëve të Brendshme dhe Punëve të Jashtme për të adresuar sfidat burokratike që lidhen me njohjen e shtetësisë shqiptare të fëmijëve të lindur nga shtetasit shqiptarë jashtë vendit. Ndhima ligjore e financuar nga shteti duhet të vihet në dispozicion të atyre që preken nga kjo gjë, për të siguruar që lindjet e tyre të jenë të regjistruara dhe t'u njihet shtetësia.
7. **Pashtetësia të përfaqësohet në qeverisje.** Qeveria shqiptare duhet të caktojë një autoritet udhëheqës me mandat për parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë, identifikimin

dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi në Shqipëri. Roli i tyre duhet të përfshijë rritjen e ndërgjegjësimit në të gjitha departamentet dhe institucionet qeveritare, duke përfshirë autoritetet e emigracionit dhe azilit, shtetësisë dhe regjistrimit civil. Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Avokati i Popullit duhet të kenë një mandat për të monitoruar dhe raportuar për këto çështje.

8. **Rritja e kapaciteteve të zyrtarëve shtetërorë.** Qeveria shqiptare duhet të mandatojë zhvillim profesional rigoroz dhe të vazhdueshëm për të gjithë zyrtarët shtetërorë, siç janë stafi i gjendjes civile, punonjësit e shëndetësisë dhe zyrtarët konsullorë, të cilët luajnë rol ligjor në procedurat e regjistrimit civil. Duke punuar me ekspertë kompetentë, Qeveria duhet të sigurojë që këta zyrtarë, vendimmarrës dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të jenë të aftë për të trajtuar mungesën e shtetësisë dhe diskriminimin, duke ofruar trajnime dhe rritje të vazhdueshme të kapaciteteve në tema kryesore duke përfshirë barazinë dhe mosdiskriminimin, mungesën e shtetësisë dhe të drejtën publike.
9. **Qasja ndaj komunitetit.** Qeveria shqiptare duhet të ofrojë programe të vazhdueshme të informimit për të përmirësuar lidhjet dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve Rome dhe institucioneve qeveritare dhe zyrtarëve. Zyrtarët shtetërorë duhet të punojnë me komunitetin për të hartuar dhe zhvilluar fushata informuese për të mësuar direkt nga komunitetet Rome, nevojat e tyre specifike dhe pengesat me të cilat ballafaqohen, për të shkëmbyer informacion me ta dhe për t'u siguruar atyre akses përmes njësive të regjistrimit të lëvizshme.
10. **Akresi në drejtësi.** Qeveria Shqiptare duhet të sigurojë mjete efektive për të gjithë ata që kërkojnë të zgjidhin statusin e tyre të dokumentacionit, duke përfshirë ndihmën ligjore me cilësi të lartë, të financuar nga shteti (që nuk kërkon dokumentacion si ai që i është mohuar atyre), heqjen e barrierave si tarifatat gjyqësore ose tarifatat për testin e ADN-së, mbikëqyrjen gjyqësore, dhe mekanizmat të forta ankimi dhe kompensimi.
11. **Grumbullimi dhe monitorimi i të dhënave.** Qeveria shqiptare dhe agjencitë ndërkombëtare duhet të forcojnë mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave të pa mbledhura (duke përfshirë përkatësinë etnike, moshën dhe gjininë) dhe të bëjnë një hartë gjithëpërfshirëse për mungesën e shtetësisë, rrezikun e saj dhe popullsisë Rome në Shqipëri, me masat e duhura duke siguruar anonimat.
12. **Mbështetje për organizatat e udhëhequra nga Romët.** Qeveria shqiptare, agjencitë ndërkombëtare, donatorët dhe aktorët e tjerë duhet të sigurojnë mbështetje financiare dhe praktike për organizatat e udhëhequra nga Romët për rritjen e kapaciteteve, fuqizimin dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit brenda komunitetit; të ofrojnë shërbime ligjore dhe shërbime të tjera për Romët; të forcojnë zërat Romë; të informojnë për iniciativat për trajtimin e paragjyqimeve shoqërore dhe diskriminimin; të kritikojnë dhe ndikojnë ligjet dhe politikat kombëtare.
13. **Anëtarësimi në BE.** Institucionet e Bashkimit Evropian duhet të sigurojnë që diskriminimi dhe mungesa e shtetësisë së Romëve në Shqipëri të trajtohet në mënyrë gjithëpërfshirëse si një çështje prioritare për procesin e anëtarësimit në BE, e duke u ndjekur nga afër gjatë negociatave të anëtarësimit dhe duke u shqyrtuar hollësisht nga Parlamenti Evropian.

- 14. Proceset e tjera rajonale dhe globale.** Iniciativa Rome 2020, Këshilli i Evropës, OSBE / ODIHR, UNHCR, UNICEF, Këshilli i të Drejtave të Njeriut, trupat e traktateve të OKB-së dhe aktorë të tjerë rajonalë dhe botërorë duhet të sigurojnë që mungesa e shtetësisë së romëve të trajtohet përmes të gjitha procedurave relevante të të drejtave të njeriut në Shqipëri si çështje shqetësuese.

9. Mirënjohe

Ky raport është përgatitur nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (ERRC), Instituti për Mungesën e Shtetësisë dhe Përfshirjen (ISI) dhe Rrjeti Evropian për Pashtetësinë (ENS). Raporti u hartua nga Anisa Metalla (TLAS), Amal de Chickera (ISI), Nicole Garbin (ERRC) dhe Ileen Verbeek (ISI), dhe u redaktua nga Amal de Chickera. Raporti përfitoi nga kontributi shtesë redaktues i Nina Murray (ENS). Ai përmban hulumtime në tryezë dhe në terren të kryera nga Anisa Metalla (TLAS). Hulumtimi shtesë në tryezë u krye nga hartuesit e raportit. Metodologjia dhe mjetet e hulumtimit u hartuan nga Amal de Chickera me ndihmën e Ileen Verbeek, dhe hulumtimi në terren u koordinua nga Senada Sali (ERRC).

Një draft i këtij raporti u rishikua nga Lorena Isla Rodriguez dhe Hortens Balla (UNHCR), Maylis de Verneuil (Save the Children) dhe Adam Weiss (ERRC). Ne dëshirojmë të shprehim falenderimet tona të sinqerta ndaj tyre për udhëzimet e tyre të vlefshme.

Raporti u korrektohet nga Bernard Rorke (ERRC). Dzavit Berisha (ERRC) bëri paraqitjen e këtij publikimi.

Partnerët e projektit i janë mirënjohtës Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) që bënë të mundur këtë raport.

Ekipi hulumtues dhe editorial është jashtëzakonisht mirënjohtës të gjithë të intervistuarve Romë dhe Egjiptian, të cilët me bujari, ndanë kohën dhe përvojat e tyre me ne, që bënë të mundur këtë raport. Jemi gjithashtu mirënjohtës për të gjithë personat nga OJQ-të, organizatat e udhëhequra nga Romët, aktorët shtetërorë, mediat, akademikët dhe agjencitë ndërkombëtare që kontribuan në hulumtim duke rënë dakord të intervistoheshin, t'i përgjigjeshin pyetjeve dhe të ndanin ekspertizën dhe perspektivat e tyre me ne. Ne gjithashtu do të donim të falënderojmë të gjithë kolegët e ERRC, ISI dhe ENS që gjithashtu ofruan udhëzimet e tyre për përfundimin e këtij drafti.

Ky raport i dedikohet të gjithë Romëve, jetët e të cilëve ndikohen nga diskriminimi, mungesa e dokumentacionit dhe e shtetësisë. Ne shpresojmë që ky do të jetë një mjet i dobishëm në luftën e tyre të vazhdueshme për drejtësi dhe përfshirje.

10. Bibliografia

Artikuj, libra, raporte dhe studime

Aleanca kundra Anti-xhipsizmit, **Anti-xhipsizmi: një dokument referimi**, Qershor 2017

Amnesty International, **Shqipëria 2015/2016**

Amnesty International, **Shqipëria 2016/2017**

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, **Vëzhgime përfundimtare mbi raportin e katërt periodik të Shqipërisë**, CEDAW/C/ALB/CO/4, Korrik 2016

Këshilli i Bashkimit Evropian, Këshilli Evropian Bruksels 14 Dhjetor 2007, **Përfundimet e Presidencës**, Bruksel, 14 Shkurt 2008 16616/1/07 REV 1, 2008

Sekretariati i Fondacionit Dekada e Përfshirjes së Romëve, **Indeksi i Përfshirjes së Romëve 2015**, Shtator 2015

Dekada e Përfshirjes së Romëve, **Raporti i Monitorimit të Shoqërisë Civile për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Integrimin dhe e Romëve dhe Plani i Veprimit të Dekadës 2012 në Shqipëri**, 2013

De Chickera A dhe Whiteman J, *Trajtimi i pashtetësisë përmes të drejtave për barazi dhe mosdiskriminim*, në van Waas L dhe Khanna M (eds), *Zgjidhja e Pashtetësisë*, Wolf Legal Publishers, 2016

De Verneuil M, **Migrimi Rom që rezulton në pashtetësi: Rasti i Bosnjës dhe Hercegovinës**, në Roma Rights: Journal të Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve 1/2014: Nuk po shkojmë asgjëkund? Romët e Ballkanit Perëndimor dhe Liberalizimi i Vizave me BE, 2014

De Verneuil M, **Pashtetësia e Romëve në Ballkanin Perëndimor: Neglizhencë apo Diskriminim?**, 2016

Komisioni Evropian kundra Racizmit dhe Intolerancës, **Raport mbi Shqipërinë** (cikli i pestë i diskriminimit), zbatuar me 19 mars 2015, CRI (2015)18, 2015

Komisioni Evropian, **Raporti Shqipëria 2016**, 2016

Komunikatë e Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, **Raport mbi zbatimin e Kornizës së BE-së për Strategjitë Kombëtare të Shteteve për Romët 2015 COM(2015) 299**, 17 Qershor 2015

Rjeti Evropian mbi Pashtetësinë, **Mbrojtja e personave pa shtetësi nga paraburgimi arbitrar: Agjenda për Ndryshim**, 2017

Parlamenti Evropian, **Një strategji Europiane për Romët**, PE 401.031 Rezolutë e Parlamentit Evropian e datës 31 Janar 2008 mbi një strategji Europiane për Romët, 2008

Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, **Fakte bazë për Romët – Shqipëri**, 2010

Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, **Dorëzim në Komisionin Evropian për komponentën e zgjerimit të Kornizës Rome të BE-së**, May 2017

Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, **Ndërhyrja e palës së tretë në Hysenaj v Shqipëri, App. No. 78961/11 (EctHR)**

Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, **Komente me shkrim për shqyrtim nga Komisioni Evropian lidhur me Përfshirjen e Romëve në Raportet e Progresit të vendeve të Ballkanin Perëndimor 2016**, Korrik 2016

Fredman S, **Diskriminimi ndërsektorial në barazinë gjinore dhe ligjin për mos-diskriminim të BE-së**, Rrjeti Evropian I ekspertëve ligjorë për çështjet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, 2016

Instituti për Pashtetësi dhe Përfshirje, **Personat pa shtetësi në botë (The World's Stateless)**, Wolf Legal Publishers, Dhjetor 2014

Instituti për Pashtetësi dhe Përfshirje, **Personat pa shtetësi në botë (The World's Stateless)**, Wolf Legal Publishers, Janar 2017

Instituti për Pashtetësi dhe Përfshirje, Rrjeti Evropian mbi Pashtetësinë, Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, **Romët Përkasin - Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë**, October 2017

Isakovic Suni M, **Krahasimi i qasjeve për luftën ndaj pashtetësisë në Shqipëri dhe Serbi**, 2015

Krasniqi G, **Rikrijimi i shtetit: (e) migracioni dhe shtetësia në Shqipëri**, në Serinë e kumtesave të Citsee 27/2013, 2013

Meçe M, **Sistemi i Drejtësisë i Aksesueshëm për të Gjithë: Rasti i Minoritetit Rom në Shqipëri**, ECMI, Shkurt 2015

Avokati i Popullit i Shqipërisë, **Raport vjetor – Mbi aktivitetin e Avokatit të Popullit, 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2015**, Shkurt 2016

Avokati i Popullit i Shqipërisë, **Raport Vjetor, Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2016**, April 2017 (në shqip)

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (Open Society Foundation for Albania - OSFA), **Hulumtim mbi Profilin Socio-Politik të Popullatës Rome në Shqipëri**, Dhjetor 2015, (në Shqip)

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (Open Society Foundation for Albania - OSFA), **Censusi për popullatën rome në Shqipëri**, Prill 2014

OSCE, **Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së Romëve**, Shtator 2016

Republika e Shqipërisë, **The Dekada e Përfshirjes së Romëve, Plani Kombëtar i Veprimeve (2010 – 2015)**, 2011

Republika e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Jashtme, **Raporti i katërt i paraqitur nga Shqipëria në pajtim me nenin 25, paragrafi 2 i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare**, Nëntor 2016

Republika e Shqipërisë, **Ministria e Miqëniës Sociale dhe Rinisë, Plani kombëtar i veprimtimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri**, Dhjetor 2015

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, **Asnjë Fëmijë nuk duhet të jetë pa shtetësi: Studim për Shqipërinë**, Rrjeti Evropian mbi Pashtetësinë, Dokument pune 05/15, 2015

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, **Raport Mbi Ndihmën Juridike Në Shqipëri**, 2013 (në Shqip)

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, **Rritja e mbrojtjes së të drejtave të të akuzuarve - Dokument politik**, Korrik 2016

Komisioni i OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, **Vëzhgime përfundimtare: Shqipëria**, Shtator 2011

Komisioni i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, **Vëzhgime përfundimtare mbi raportin e katërt periodik të Shqipërisë**, Korrik 2016

Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët, **Analizë dhe Komete për Projektligjin për Shtetësinë Shqipëtare**, Prill 1998

Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët, **Përpilimi i rekomandimeve që kanë të bëjnë me pashtetësinë e bërë gjatë ciklit të parë (seancat 1 - 12) të Reçensionit Periodik Universal të Këshillit të të Drejtave të Njeriut**, Korrik 2013

Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët, **Manual për Mbrojtjen e Personave pa Shtetësi sipas Konventës së vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi**, Gjenevë, 2014

Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët, **Parashtrim nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët për Përgatitjen e Raportit të Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut – Reçensionit Periodik Universal: SHQIPËRIA**

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Shqipëri, **Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri**, Shkurt 2012

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Shqipëri, **Raporti përfundimtar i projektit të financuar nga BE-ja – Mbështetje për përfshirjen sociale të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri**, 2015

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Shqipëri, **Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: një profil socio-demografik dhe ekonomik i bazuar në Censusin e vitit 2011**, April 2015

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Shqipëri, **Romët në Shqipëri**, Qershor 2012

UNICEF, **Kostoja e nëninvestimit në arsim: Dhe mënyrat për ta ulur atë**, 2017

Vermeersch P, **Mes Evropianizimit dhe diskriminimit: romët si një fokus i veçantë i politikës së BE**, në Mobiliteti Rom në Evropë: Konferenca Ndërkombëtare Perspektiva Shumëdisiplinore, University of Oxford, 14-15 Janar 2010

Faqe interneti të dobishme

Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, **Raporte mbi aktivitetet e Komisionerit**, (në shqip)

Këshilli i Evropës, **Fjalor përshkrues i termave lidhur me çështjet e romëve**

Këshilli i Evropës, **Fletë Informuese për Kulturën Rome**

Këshilli i Evropës, **Fletë Informuese mbi Historinë e Romëve: Hyrje e Përgjithshme**

Këshilli i Evropës, **Romët dhe Udhëtarët**

Këshilli i Evropës, **Komiteti European për Bashkëpunimin Ligjor**

Observatori Demokratik i Bashkimit Evropian për Shtetësinë, **Mbrojtja nga të Dhënat e Pashtetësisë**

OSCE, **Romët dhe Sinti**

Roma Integration 2020, Roma in the Region, The size of the Roma Community in the Region

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Shqipëri, **Plani kombëtar i veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri**

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Shqipëri, **Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët - një nxitje për përfshirjen sociale**

Traktatet e Kombeve të Bashkuara

Konventa mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, G.A. Res. 2200A (XXI), 1976

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, G.A. Res. A/RES/34/180, 1979

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, G.A. Res. A/RES/44/25, 1989

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike International, G. A. Res. 2200A (XXI), 1976

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, G.A. Res. A/RES/51/80

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, A/RES/61/106

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Reduktimin e Pashtetësisë, U.N.T.S. 989, 1961

Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin e personave pa shtetësi, 360 U.N.T.S. 117, 1954

Traktatet Rajonale

Versione të konsoliduara të Traktatit për Bashkimin Evropian dhe Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian 2012 / C 326/01

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Konventa Evropiane mbi Shtetësinë

The Qendra Europiane për Të Drejtat e Romëve (European Roma Rights Centre - ERRC) është një organizatë e të drejtës ndërkombëtare publike e orientuar drejt çështjeve rome dhe që punon për të luftuar racizmin dhe abuzimin e të drejtavë të tyre. Qasja e ERRC përfshin litigimin strategjik, advokim ndërkombëtar, kërkim dhe zhvillim politikash dhe trainim të aktivisteve Romë. ERRC ka një status këshillimor në Këshillin e Europës, si dhe në Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara.

Rrjeti European i Pashtetësisë (European Network on Statelessness – ENS) është një aleancë e shoqërisë civile me më shumë se 100 anëtarë në 40 vende, të angazhuar për të adresuar çështjen e pashtetësisë në Europë. ENS beson se të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejtën e një shtetësie dhe se ata që nuk kanë kombësi krejtësisht kanë të drejtën e mbrojtjes së plotë. ENS synon të arrijë misionin e saj nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit, aktiviteteve ligjore dhe hartimit të politikave, si dhe përmes ndërtimit të kapaciteteve.

Instituti për Pashtetësi dhe Përfshirje (Institute on Statelessness and Inclusion - ISI) është një organizatë e pavarur jofitimprurëse e angazhuar për të reaguar në mënyrë të integruar dhe në bazë të të drejtave të njeriut, nëpërmjet një kombinimi të kërkimit, arsimit, partneritetit dhe avokimit, në lidhje me padrejtësinë e pashtetësisë dhe përjashtimit.

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (Tirana Legal Aid Society - TLAS) është një nga OJQ-të më të mëdha në Shqipëri që merret me çështjen e pashtetësisë. TLAS ofron shërbime të ndihmës juridike falas për mijëra fëmijë dhe të rritur pa shtetësi dhe vazhdon të punojë për përmirësimin e sistemit të regjistrimit të lindjeve në partneritet me qeverinë shqiptare. Misioni i TLAS është përmbushja e nevojave ligjore dhe sociale të të varfërve, edukimi dhe sensibilizimi i shoqërisë shqiptare mbi sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut; dhe ndërmarrja e nismave për përmirësimin e sistemit ligjor, zhvillimin e komunitetit dhe forcimin e demokracisë në Shqipëri.

Projekti Romët Përkasin (#RomaBelong) është një iniciativë e përbashkët e Qendrës Evropiane për të Drejtat e Romëve (ERRC), Institutit për Pashtetësi dhe Përfshirje (ISI) dhe Rrjetit European mbi Pashtetësinë (ENS) në bashkëpunim me organizatat partnere në Shqipëri (Shërbimi Ligjor Falas Tiranë), Bosnje Hercegovinë (Vaša prava BiH Association), Maqedoni (Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas - Macedonian Young Lawyers Association), Mali i Zi (Mladi Romi), Serbi (Praxis) dhe Ukrainë (Desyate Kvitnya). Projekti synon të kuptojë më mirë dhe të adresojë pashtetësinë rome (dhe rrezikun e pashtetësisë) në vendet e Ballkanit Perëndimor kandidate dhe fqinje të Bashkimit Evropian (Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi) dhe Ukrainë.

CHALLENGING DISCRIMINATION PROMOTING EQUALITY



European
Network on
Statelessness

